



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 53801-00461-2021 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2021-670 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Illir PANDA	Kryesues
Klodian KURUSHI	Anëtar
Asim VOKSHI	Anëtar

sot, në datë 26.10.2021, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

KUNDËR: Luan Daci

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 Kodit Penal.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Klodian Kurushi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi i kësaj çështjeje me procedurën e gjykimit të zakonshëm rezultoi se Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në datën 07.02.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. 56, të vitit 2020, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i Kodit Penal, në ngarkim të personit nën hetim Luan Daci.

2. Me vendimin nr. 82/2017, datë 17.06.2017¹, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë shtetasi Luan Daci është zgjedhur Gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, një nga institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aneksi “Rivlerësimi Kalimtar i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, neni C “Dispozita të Përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Apelit ” dhe ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

¹Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 133, datë 19.06.2017

Shqipërisë”. Zgjedhja e tij në përbërje të këtij institucioni kushtetues ka ardhur si pasojë e një procesi të administruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

3. Në datën 03.02.2017 shtetasi Luan Daci ka paraqitur kërkesë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me objekt “Për aplikimin, emërimin e kërkuesit në vendet vakante të shpallura në bazë të ligjit nr. 84/2016”, dhe ka aplikuar për t’u emëruar në vendin vakant a) Gjyqtar i Kolegjit të Apelit; b) Anëtar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; c) Komisioner publik. Kjo kërkesë për aplikim, është paraqitur në dy kopje; një kopje në gjuhën shqipe dhe një kopje në gjuhën angleze, të nënshkruara prej tij. Në kërkesën për aplikim, i pandehuri Luan Daci, ndër të tjera, ka deklaruar se “...kam ushtruar profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë, i regjistruar në këtë dhomë në datën 27.03.2000, jam vlerësuar për aftësitë e mia profesionale dhe me rekomandime të profesorëve të këtij fakulteti për jetën akademike, ndaj meje nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit”.

4. Në dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës për aplikim, aplikuesi ka paraqitur edhe një CV (jetëshkrim) në të cilën, midis të tjerave, është përshkruar se ka ushtruar kurse në Shkollën e Magjistraturës në periudhën 1995-1996, është titulluar avokat me numër licence 888. Në CV-në e paraqitur shtetasi Luan Daci, nuk ka përshkruar faktin se ka ushtruar funksionin e Gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Në seancën dëgjimore të datës 02.06.2017, të zhvilluar nga komisioni ad hoc i Kuvendit me gjashtë anëtarë, për përzgjedhjen e kandidatëve për krijimin e institucioneve të rivlerësimit, shtetasi Luan Daci pyetjes nëse ka punuar para vitit 2000 i është përgjigjur se ka punuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pyetjes së Komisionit se sa vjet ka punuar si gjyqtar dhe pse është larguar nga funksioni, shtetasi Luan Daci i është përgjigjur në këtë mënyrë: “Kam filluar në shtator të vitit 1993, fillimisht si ndihmës gjyqtar, kur kemi dhënë diplomën para komisionit shtetëror, dy ditë pas dhënies së diplomës, jam emëruar gjyqtar në Gjykatën e Tiranës, madje jam emëruar edhe nënkryetar në Gjykatën e Tiranës, deri në 24 dhjetor të vitit 1997 unë kam qenë gjyqtar në Gjykatën e Tiranës”. Pyetjes tjetër nga anëtari i komisionit nëse në vitin 1997 është larguar, ka ikur apo e kanë hequr shtetasi Luan Daci i është përgjigjur se: “Unë kam ikur me dorëheqje, sepse nuk na lejuan të regjistroheshim”.

6. Ndërkohë, nga një kallëzim i paraqitur në Prokurorinë e Posaçme dhe materialet bashkëngjitur atij, ka rezultuar se shtetasi Luan Daci deri në vitin 1997 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 6, datë 24.12.1997, pas propozimit të Ministrit të Drejtësisë, në nenin 1, ka vendosur: “Z. Luan Daci, largohet nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjës dhe paaftësi në detyrë”. Sipas përmbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë të datës 24.12.1997 ka rezultuar se shtetasi Luan Daci ka qenë i pranishëm personalisht në këtë mbledhje dhe ka parashtruar qëndrimin dhe shpjegimet e tij ndaj kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për largimin nga detyra. Gjithashtu, shtetasi Luan Daci ka paraqitur në vitin 2016 kërkesë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë për emërimin në detyrën e gjyqtarit, kërkesë që është marrë në shqyrtim në mbledhjen e datës 15.11.2016, por ai është skualifikuar me arsyetimin se është larguar nga detyra me vendimin nr. 7, datë 24.12.1997, të KLD-së.

7. Mbi këto fakte, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, mbi bazën e kallëzimit penal nr. 36, datë 27.01.2020, datë 07.02.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. 56 të vitit 2020, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i Kodit Penal. Me vendimin e prokurorëve të datës 15.07.2020, personit nën hetim Luan Daci i është komunikuar akuza duke u marrë më cilësinë e të pandehurit për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

8. Në mbështetje të akuzës prokuroria ka argumentuar se i pandehuri duke mos e deklaruar masën disiplinore në dokumentin “Kërkesë drejtuar Avokatit të Popullit për aplikim” ka pasqyruar një fakt të rremë në këtë deklaram, kërkesë. Kjo pasi në nenin 6, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 janë parashikuar kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, duke përfshirë edhe gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Sipas kësaj dispozite të ligjit, Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:

b) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur të fushës së të drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

Sipas prokurorisë masa disiplinore nuk parashkruhet e si e tillë ajo duhej të ishte deklaruar, edhe për shkak se i pandehuri e ka mohuar masën disiplinore dhe në deklaramin e datës 02.06.2017 para Komisionit të Kuvendit me gjashtë anëtarë për përzgjedhjen e kandidatëve për krijimin e institucioneve të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Prokuroria, në funksion të akuzës, ka interpretuar germën (dh) të dispozitës ligjore të mësipërme, sipas kuptimit që kriteri “ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna” është i pavarur nga pjesa tjetër e fjalisë “e cila është ende në fuqi”, ku kjo e fundit i referohet pjesës nënrenditëse të fjalisë “ndonjë masë tjetër disiplinore” dhe jo masës së largimit nga puna. Për akuzën, në çdo rast është kriter përjashtues ekzistenca e një mase të mëparshme të largimit nga puna, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore.

10. Sipas Prokurorisë ky kusht është parashikuar dhe në ligjin nr. 96/2016, në kriteret e emërimit të kandidatëve jo gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, në nenin 49/2 dhe në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, në kriteret dhe kushtet e emërimit të Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të parashikuara në nenin 7/a, paragrafi (1) përcaktohet që: d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

11. Sipas akuzës, në secilin prej këtyre rasteve parashikohet si kriter përjashtues ekzistenca e një mase të mëparshme të largimit nga puna, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore. Periudha kohore brenda të cilës masa disiplinore duhet të jetë në fuqi, në asnjë rast nuk lidhet me masën disiplinore të largimit apo shkarkimit nga detyra, por lidhet me masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji. Ekzistenca e masës disiplinore “*largim nga detyra*” të shtetasit Luan Daci si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, passjell mospërmbushjen nga ana e këtij shtetasi të kriterit të parashikuar në nenin 6/1, germa (dh) të ligjit nr. 84/2016, për emërimin e tij Gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

12. Për prokurorinë kërkesa e shtetasit Luan Daci e datës 03.02.2017 drejtuar Avokatit të Popullit, pavarësisht se një akt i plotësuar nga vetë i pandehuri, është një akt i domosdoshëm i kërkuar nga ligji dhe si i tillë ai është dokument, në formën e vetdeklarimit që materializon vullnetin e personit për mungesën e masës disiplinore ndaj tij. Shtetasi Luan Daci, në kërkesën për aplikim të depozituar në datën 03.02.2017 në Institucionin e Avokatit të Popullit, për vendet vakante gjyqtar i Kolegjit të Apelit, anëtar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisioner Publik, ka paraqitur rrethana të rreme duke fshehur faktin se ndaj tij është marrë masa disiplinore “*largim nga detyra*” si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas akuzës kjo përbën faktin penal të falsifikimit të dokumenteve pasi i pandehuri ka shmangur përgjegjësinë e deklaramit të saktë e të vërtetë për plotësimin e kriterëve formale të parashikuara e të kërkuara nga ligji, duke konsumuar kështu elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet, “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

13. I pandehuri Luan Daci dhe mbrojtësit të tij gjatë procedimit penal kanë mohuar përgjegjësinë penale dhe kanë kërkuar deklarinë e tij të pafajshëm, duke pretenduar se nuk ekziston fakti penal, nuk ka dokument të falsifikuar dhe për rrjedhojë nuk ka vepër penale. Nga ana e mbrojtësve të të pandehurit u pretendua se Prokuroria ka gabuar kur ka cilësuar falsifikim faktin që personi nën hetim ka parashtruar në kërkesën e tij që nuk ka masa disiplinore në fuqi në kohën e bërjes së kërkesës, duke e cilësuar këtë si një të dhënë të rreme. Sipas qëndrimit të mbrojtjes masa administrative e dhënë ndaj tij është shuar.

14. Mbrojtja ka parashtruar gjatë gjykimit të themelit të çështjes se vepra penale për të cilën është i akuzuar gjyqtari Luan Daci, nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë sepse vepra penale e "Falsifikimit të dokumenteve" ka si element të anës objektive ndërhyrjen në një dokument origjinal nga një person i paautorizuar për lëshimin e tij ose nga personi që e lëshon atë, duke shtuar, ndryshuar ose hequr elemente të përmbajtjes së tij. Nga ana subjektive realizohet vetëm me dashje direkte, ndërkohë që në rastin konkret edhe nëse do të provohej varianti i prokurorisë ose Gjykatës që është i vërtetë, përsëri vlerësimi i bërë nga i pandehuri Luan Daci ne lidhje me këtë fakt është liri e mendimit dhe vlerësimit të tij profesional të pavarur dhe kurrësi ai nuk do të bënte një gjë të tillë nëse do ta dinte që ky vlerësim do të ishte vepër penale.

15. Mbrojtja argumenton se Luan Daci nuk ka pasur ndonjë formular dhe nuk i është vënë në dispozicion ndonjë formular i posaçëm për ta plotësuar si kërkesë për aplikim duke përfshirë formular të miratuar në mënyrën e strukturimit dhe përmbajtjes së CV të tij. Kërkesa ashtu dhe jetëshkrimi janë akte individuale, jo shkresa zyrtare dhe as formular i konceptuar nga institucionet shtetërore apo komisionet e posaçme, sepse nuk ka rëndësi kërkesa por procesi i verifikimit të mëvonshëm.

16. I pandehuri pretendoi se në këtë procedurë të qartë administrative dhe në këtë proces penal nuk rezultoi asnjë dokumentacion bashkëshoqërues - shkresë zyrtare e falsifikuar, e tjetërsuar në kuptim të nenit 186/1, 186/3, 188, 189, 190, 191 të Kodit Penal. Ky fakt, si në procedurën administrative dhe tashmë në procesin penal, nuk ekziston. Gjithashtu nuk ekziston asnjë formular vetdeklarimi (zyrtar), i miratuar me ligj, ku i pandehuri të ketë bërë pohim për të dhëna të rreme në këtë formular të kërkuara nga elementet e tij, pra nuk ka falsifikuar asnjë formular zyrtar apo dokument zyrtar. Dokumentacioni i paraqitur nga i pandehuri bashkëngjitur kërkesës është një dokumentacion i plotë, shkresa zyrtare të plota, të sakta dhe të patjetërsuara. Ato janë marrë në rrugë zyrtare vetëm nga organe zyrtare.

17. Sipas të pandehurit formularët e vetdeklarimit janë akte zyrtare të miratuar me ligj dhe në rastin konkret as kërkesa as CV nuk janë formularë vetdeklarimi dhe kjo provohet qartë nga aktet që janë miratuar me ligjin nr. 84/2016, si formularë vetdeklarimi dhe të plotësuara në mënyrë korrekte për të gjitha të dhënat e kërkuar në to. Pra as kërkesa nuk përbën formular vetdeklarimi. Sipas të pandehurit përshkrimi në kërkesë si dhe përshkrimet në CV jo vetëm që janë në përputhje me të dhënat e dokumenteve shoqëruese, por nuk parashikohen nga Kodi Penal si vepër penale. Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e dokumentit zyrtar të tjetërsuar në të dhëna apo në ekstremite formale si vula, firma, stema dhe nuk parashikon ndonjë formë tjetër falsifikimi, tjetërsimi me intelektualizëm.

18. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 32, datë 01.12.2020, ndër të tjera, ka vendosur: *"1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Luan Daci, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", të parashikuar nga neni 186/1 i KP dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.*

Në bazë të nenit 63 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale brenda një afati prove prej 12 muajsh. "

19. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar ndër të tjera ka arsyetuar se, mbi bazën e rezultateve të shqyrtimit gjyqësor para kësaj gjykate shtrohet për vlerësim nëse në këtë proces jemi përpara rastit të dokumentit që i referohet kërkesës për

aplikim/vetdeklarim? A ka qenë i detyruar i pandehuri të pasqyrojë në këtë kërkesë masën e largimit nga puna dhe cili ka qenë qëllimi i tij në mosdeklarim? Ky fakt a përmban elemente të falsifikimit të dokumenteve e për rrjedhojë a ka konsumuar i pandehuri veprën penale për të cilën ai është sjellë në gjykim nga Prokuroria e Posaçme?

20. Në lidhje me çështjen e parë, gjykata ka konkluduar se kërkesa apo vetdeklarimi për masën disiplinore nuk ka pasur ndonjë formë të veçantë por mund të hartohet nga vetë aplikuesi, duke përbërë një akt deklarativ të vetë personit kandidat për funksionin publik. Akti “Kërkesë” i datës 03.02.2017 i depozituar nga shtetasi Luan Daci, duke qenë një akt formal që kërkohet domosdoshmërisht nga ligji për fillimin e procedurës, i cili është në gjendje që të sjellë efektet juridike dhe që ka shërbyer për fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së shtetasit Luan Daci si gjyqtar, i plotëson të gjithë elementet e domosdoshëm të “dokumentit”, si objekt material i veprës penale të parashikuar nga neni 186 paragrafi i parë i Kodit Penal. Kërkesa datë 03.02.2017 konsiderohet “dokument”, pasi në thelb ajo është një shkresë e cila ka shërbyer për të dëshmuar dhe vërtetuar diçka, ajo përbën një akt të shkruar ku janë pasqyruar kriteret që plotëson kandidati, referuar parashikimeve ligjore të bëra në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016.

21. Kjo kërkesë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, pavarësisht se është një shkresë e plotësuar nga vetë shtetasi Luan Daci, sipas vlerësimit të Gjykatës së Posaçme të shkallës së parë ka qenë një akt i domosdoshëm dhe i kërkuar nga ligji për fillimin e procedurës së kandidimit dhe përzgjedhjes në institucionet e rivlerësimit, i parashikuar në nenin 7, paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të ligjit nr. 84/2016. Në paragrafin e katërt të kësaj dispozite është parashikuar shprehimisht detyrimi ligjor që bashkëlidhur me kërkesën që paraqitet, kandidati duhet të dorëzojë kopje të dokumenteve lidhur me jetëshkrimin profesional, si dhe të dokumenteve që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji. Si akt i tillë ai ka sjellë pasojën e dëshiruar atë të zgjedhjes së të pandehurit në Institucionin e Lartë Kushtetues të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

22. Në këtë mënyrë, akti “Kërkesë” i datës 03.02.2017 i depozituar nga shtetasi Luan Daci, duke qenë një akt formal që kërkohet domosdoshmërisht nga ligji për fillimin e procedurës, i cili është në gjendje që të sjellë efektet juridike dhe që ka shërbyer për fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së shtetasit Luan Daci si gjyqtar, i plotëson të gjithë elementet e domosdoshëm të “dokumentit”, si objekt material i veprës penale të parashikuar nga neni 186 paragrafi i parë i Kodit Penal. Kërkesa datë 03.02.2017 konsiderohet “dokument”, pasi në thelb ajo është një shkresë e cila ka shërbyer për të dëshmuar dhe vërtetuar diçka, ajo përbën një akt të shkruar ku janë pasqyruar kriteret që plotëson kandidati, referuar parashikimeve ligjore të bëra në nenin 6 të Ligjit nr. 84/2016.

23. Në lidhje me detyrimin e të pandehurit për deklarim të masës disiplinore të largimit nga puna gjykata arsyeton se Kushtetuta në nenin C paragrafi 5 të Aneksit të saj, ka parashikuar kriteret kualifikuese për të qenë Gjyqtarë i Kolegjit të Apelit. Në zbatim të nenit 7, paragrafi 4, germa (c) të ligjit nr. 84 të vitit 2016 shtetasi Luan Daci ka pasur detyrimin ligjor që të provonte plotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 6 i këtij ligji, ku sigurisht përfshihet edhe germa (dh).

24. Pavarësisht periudhës kohore se kur është vendosur masa disiplinore e shkarkimit apo largimit nga detyra, sipas nenit 150/3 të ligjit nr. 96/2016 që ka qenë në fuqi në momentin e aplikimit të kandidatëve për Gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, masa disiplinore e “shkarkimit nga detyra”, e cila nga natyra dhe efektet e saj është e njëjtë me masën disiplinore “largim nga puna” që parashikohej në nenin 20 të ligjit nr. 7574, datë 24.06.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile”, që ka qenë në fuqi në datën 24.12.1997, nuk konsiderohet se është shuar me kalimin e ndonjë afati kohor të caktuar.

25. Duke u nisur nga rrethanat dhe faktet e mësipërme, duke vlerësuar vlerën provuese të provave të administruara, duke analizuar dispozitat ligjore të zbatueshme në rastin konkret, gjykata

vlerëson se, i pandehuri Luan Daci në kërkesën për aplikim të depozituar në datën 03.02.2017 në Institucionin e Avokatit të Popullit, për vendet vakante gjyqtar i Kolegjit të Apelimit, anëtar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisioner Publik, ka paraqitur rrethana të rreme duke fshehur faktin se ndaj tij është marrë masa disiplinore “largim nga detyra” si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ekzistenca e masës disiplinore “largim nga detyra” të shtetasit Luan Daci si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, passjell mospërmbushjen nga ana e këtij shtetasi të kriterit të parashikuar në nenin 6/1, germa (dh) të ligjit nr. 84/2016, për emërimin e tij Gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

26. Veprimet e kryera nga ana e shtetasit Luan Daci, duke mospërmendur në CV dhe në aktivitetin profesional faktin se ka ushtruar funksionin e gjyqtarit për rreth tre vjet, madje edhe funksionin e Nënkryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe deklarimi i rremë i këtij shtetasi në seancën dëgjimore të komisionit ad hoc në Kuvendin e Shqipërisë të datës 02.06.2017, ku ka shpjeguar se nga detyra e gjyqtarit ai është larguar me dorëheqje, konfirmojnë faktin se rrethana e rremë e deklaruar prej tij në kërkesën e datës 03.02.2017 në pikën (f) të saj, është deklaruar me dashje direkte dhe me qëllim për të fshehur faktin se ndaj tij është marrë masë disiplinore “largim nga detyra”, e cila nëse do të ishte deklaruar apo do të ishte zbuluar do e skualifikonte shtetasin Luan Daci nga procesi i emërimit të tij si Gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

27. Dokumenti/kërkesë i datës 03.02.2017 edhe për Gjykatën e Posaçme të shkallës së parë ka përmbajtjen e një vetdeklarimi jo të saktë, pasi në këtë akt dokument, i pandehuri ka materializuar pasqyrimin e një rrethane të rremë si një fakt të vërtetë atë të mospasjes së masës disiplinore të largimit nga puna. Ky pasqyrim i rrethanës se rremë si fakt i vërtetë ka dhënë efekt juridik pasi ka shërbyer si kusht për plotësimin e kriterit formal të parashikuar nga neni 6/1 shkronja dh) i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, dhe si i tillë ai ka dhënë pasoja/efekt në zgjedhjen e aplikuesit/të pandehurit në organin e lartë të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

28. Falsifikimi intelektual është lloji i falsifikimit në të cilin autori është personi që ka hartuar dokumentin por përmbajtja e dokumentit nuk është e saktë. Nga pikëpamja e elementëve të veprës penale falsifikimi intelektual përbëhet nga elementi objektiv dhe subjektiv: I pari i referohet sjelljes konkrete që autori duhet të kryejë për të integruar sjelljen kriminale të tij të parashikuar nga ligji penal e dyta ka të bëjë me gjendjen psikologjike të autorit. Nga këndvështrimi i parë ai i sjelljes falsifikimi intelektual mund të realizohet përmes pohimit të një rrethane a fakti që nuk ekziston ose mohimit të një fakti që ekziston në të vërtetë. Çdo deklaram që nuk korrespondon të vërtetën integron falsifikimi intelektual. Në vijim të këtij argumentimi, gjykata klasifikon veprimin e të pandehurit Luan Daci si falsifikim intelektual.

29. Në përfundim të këtij argumentimi, Gjykata çmon se nga provat e marra e të shqyrtuara, krijohet bindja se i pandehuri Luan Daci, për tu promovuar në një nga vendet e lira të shpallura Gjyqtar i Kolegjit të Apelimit; Anëtar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; Komisioner Publik, në kërkesën e depozituar në Institucionin e Avokatit të Popullit datë 03.02.2017, pasqyroi të dhëna të rreme. Ky pasqyrim në aktin në fjalë u bë me qëllimin e posaçëm shmangien e mundësisë të skualifikimit si kandidat, për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore të parashikuara në nenin 6 pika 1 germa “dh” të ligjit nr. 84/2016. Fakt i largimit nga detyra për shkak të shkeljes së ligjit, nuk iu bë i ditur as anëtarëve të Komisionit të Kuvendit, të cilët mbi pyetjen e drejtuar kandidatit mbi arsyet e largimit, duke ju referuar detyrës që ai kryente në vitin 1997, morën si përgjigje se largimi ishte bërë me dorëheqje (në këtë vit ai kryente detyrën Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë).

30. Si konkluzion, Gjykata vlerëson në këtë rast jemi para ekzistencës së faktit penal, se i pandehuri Luan Daci ka konsumuar elementët e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve” të

parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal e se ai duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale.

31. Ndaj vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim i pandehuri Luan Daci, me të cilin ka kërkuar ndryshimin/prishjen e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Luan Daci për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, për shkak se del qartë se fakti penal nuk përbën vepër penale dhe në thelb as nuk ekziston.

32. Në ankim kërkuesi ka parashtruar ndër të tjera këto shkaqe:

- Fakti penal i falsifikimit të dokumenteve nuk ekziston, nuk ka dokument të falsifikuar dhe për rrjedhojë nuk ka vepër penale. Gjykata e ka vlerësuar gabim faktin penal, pasi veprimet administrative aplikuese të z. Luan Daci si shfaqës interesi për vendet vakante të organeve të rivlerësimit, nuk përbën vepër penale. Gjykata ka dhënë vendim fajësie ku shtetasi Luan Daci nuk rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet, pasi kërkesa për aplikim jo vetëm që nuk është një dokument zyrtar i falsifikuar, i tjetërsuar, por është një akt i shfaqjes së interesit në një procedurë administrative, është një akt diskrecionar i lejueshëm në këtë procedurë administrative nga neni 47 i Kodit të Procedurave Administrative, neni 58 pika 1 dhe 2 e 61 i po këtij Kodi, neni 7/1 të ligjit 84/2016 etj.
- Nuk kemi të bëjmë me një veprim të kundërligjshëm, shoqërisht të rrezikshëm, nuk është kryer me faj.
- Z. Luan Daci në asnjë formular vetdeklarimi, nuk ka bërë deklaramë të pasakta, të pavërteta apo të rreme, të cilat po të ishin evidente do të penalizoheshin, me nenin 190 paragrafi 1 i Kodit Penal. Gjykata ka gabuar kur ajo me qëllim të të provuarit të akuzës ka alternuar elementët e dispozitës 190/1 me elementë të nenit 186/1 të Kodit Penal. Vetdeklarimi i gabuar në formular çon në veprën penale të parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal, ndërsa falsifikimi i dokumenteve kërkon domosdoshmërisht ekzistencë e objektit të veprës penale, të elementit të veprës penale, dokumentin e falsifikuar. Pra, janë dy nocione dhe institute krejt të ndryshme që as mund të bashkohen e as mund të alternohen elementët e njëres vepër me elementët e veprës tjetër
- Kërkesa nuk mund të interpretohet në mënyrë të zgjeruar jashtë kuptimit të ligjit administrativ në këtë marrëdhënie, duke e vetëquajtur gjykata kërkesën si vetdeklarim.
- Formularët e vetdeklarimit janë akte zyrtare të miratuar me ligj dhe në rastin konkret, as kërkesa as CV nuk janë formularë vetdeklarimi dhe kjo provohet qartë nga aktet që janë miratuar me ligjin 84/2016, si formularë vetdeklarimi dhe të plotësuar në mënyrë korrekte për të gjitha të dhënat e kërkuar në to.
- Problemi i ekzistencës apo mosekzistencës së masës disiplinore në fuqi është një çështje interpretimi ligjor, dhe bindja ime ka qenë dhe është se, të gjitha masat disiplinore në fund të fundit janë kundërvajtje administrative, janë të parashkruara. Kjo do të thotë që efektet juridike të tyre shuhën.
- Gjykata kishte dhe ka ndalim për të dhënë masën ndaluese të sigurimit personal të “Pezullimit të ushtrimit të detyrës”, pasi z. Luan Daci sipas aneksit C të Kushtetutës gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe shkeljet disiplinore të tij shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Ky përfundim vërtetohet nga vetë shkresa e gjykatës nr. 5354 datë 23/07/2020 që i është dërguar Gjykatës Kushtetuese, për pezullimin e z. Daci nga detyra pasi mori cilësinë e të pandehurit. Me këtë shkresë pranohet në thelb se gjithçka që ka bërë e vlerësuar prokuroria ka qenë e gabuar.
- Prokuroria dhe më pas gjykata, kanë gabuar kur kanë cilësuar falsifikim faktin që i pandehuri ka parashtruar në kërkesën e tij “që nuk ka masë disiplinore në fuqi në kohën e bërjes së kërkesës”, duke e cilësuar këtë si të dhënë të rreme. Kjo pasi masa administrative është shuar. Masa disiplinore e dhënë ndaj z. Daci është e datës 24/12/1997, fiks 23 vite

dhe prej asaj kohe ai nuk ka marrë asnjë masë disiplinore. Është shkelur parimi i proporcionalitetit.

- Masa disiplinore ndaj z. Daci është dhënë në datë 24/12/1997 dhe ligjet për organizimin e gjyqësorit deri në vitin 2008 nuk parashikonin rregulla për shuarjen, kjo nënkupton se ligji i parë i kohës që parashikon shuarjen është ai i vitit 2008, sipas të cilit në çdo rrethanë është shuar masa disiplinore, pasi sipas këtij ligji masa disiplinore për largimin detyra shuhet brenda 3 viteve nga data e dhënies së saj.
- Vepra penale për të cilën akuzohet z. Luan Daci, nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë. Vepra penale “falsifikimi i dokumenteve” ka si element të anës objektive ndërhyrjen në një dokument origjinal nga një person i paautorizuar për lëshimin e tij ose nga personi që e lëshon atë, duke shtuar, ndryshuar ose hequr elementë të përmbajtjes së tij. Nga ana subjektive realizohet vetëm me dashje direkte, ndërkohë që në rastin tonë edhe nëse do të provohej varianti i prokurorisë ose gjykatës si i vërtete, përsëri vlerësimi i bërë nga z. Luan Daci në lidhje me këtë fakt, është liri e mendimit dhe vlerësimit të tij profesional të pavarur, por kurrësi ai nuk do të bënte një gjë të tillë nëse do ta dinte që ky vlerësim do të ishte vepër penale. Pra, kurrësi nuk jemi para dashjes direkte, pasi një gjë e tillë është objektivisht e paprovueshme në këndvështrimin e akuzës dhe gjykatës, përse kohë është çështje lirie mendimi dhe shprehje te vlerësimit.
- Kërkesa ashtu dhe jetëshkrimi janë akte individuale, jo shkresa zyrtare.
- Falsifikimi ideologjik ose intelektual nuk njihet nga legjislacioni ynë penal dhe as nga jurisprudenca shqiptare.
- Prokuroria ka zhvilluar hetime jashtë kompetencave të caktuara në kundërshtim me nenin 277 të K.Pr.Penale.
- Luan Daci nuk ka pasur ndonjë formular dhe nuk i është vënë në dispozicion ndonjë formular i posaçëm për ta plotësuar si kërkesë për aplikim, duke përfshirë formular të miratuar më mënyrën e strukturimit dhe përmbajtjes së CV të tij. Rregullorja e miratuar në formën e protokollit nga Avokati i Popullit është miratuar disa javë pasi z. Daci të paraqiste kërkesën për kandidim dhe dokumentacionin mbështetës, duke përfshirë dhe plotësimin e këtij dokumenti. Z. Luan Daci nuk kishte detyrim apo kërkesë për të deklaruar pasjen ose jo të masave disiplinore të mëparshme, ka paraqitur pranë Avokatit të Popullit si dokumentacion mbështetës krahas dokumenteve të tjera edhe atë të vërtetimit të punës që ka qenë ish gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dokumenti në fjalë është pasqyruar dhe në vërtetimin e inventarit të dokumentacionit të paraqitur pranë Avokatit të Popullit.

33. Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka paraqitur apel kundërshtues me të cilin ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

34. **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, me vendimin nr. 5, datë 08.03.2021, ndër të tjera, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 32 datë 01.12.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.”

35. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar në të njëjtën linjë me gjykatën e shkallës së parë, (*omissis*), duke argumentuar ndër të tjera se i çmon të pabazuara pretendimet e ngritura në ankimin e kërkesit. Së pari, Gjykata e Posaçme e Apelit e vlerëson të pabazuar në ligj pretendimin e të pandehurit dhe mbrojtësve se nuk ekziston vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, pasi kërkesa për aplikim nuk është akt zyrtar, por është shfaqje interesi për të aplikuar në një proces administrativ. Kolegji vlerëson se “kërkesa për aplikim” depozituar në datë 03.02.2017 pranë Avokatit të Popullit nga kandidati aplikues Luan Daci është dokument. Paraqitja e këtij akti është një kërkesë e parashikuar shprehimisht në ligjin nr. 84/2016. Aplikimi/kërkesa për t’u përzgjedhur

në njërin nga pozicionet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është akti/dokumenti që shënon fillimin e procedurës së përzgjedhjes. Bashkangjitur kërkesës aplikanti duhet të dorëzojë edhe dy kopje të dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kushteve të parashikuara në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, edhe ky kolegji ashtu si gjykata e shkallës së parë vlerëson se aplikimi/kërkesa është një akt që dokumenton vullnetin e kandidatit jo vetëm për të aplikuar për njëri nga pozicionet në institucionet e rivlerësimit, por edhe deklarimin e tij për plotësimin e kriterëve formale të parashikuara në ligj, kriterë këto të domosdoshme për t'u emëruar në institucionet e vlerësimit kalimtar.

36. Në ndryshim nga sa pretendon mbrojtja, edhe ky kolegji vlerëson se akti “kërkesë/aplikim” i depozituar në datën 03.02.2017 nga shtetasi Luan Daci është akt formal që kërkohet domosdoshmërisht nga ligji për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit. Akti formal sjell efektet juridike dhe plotëson të gjithë elementët e domosdoshëm të dokumentit, si objekt material i veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

37. Së dyti, ky kolegji vlerëson të pabazuar në ligj pretendimin e të pandehurit dhe mbrojtësve se shtetasi Luan Daci nuk ka bërë deklarime të pasakta, të pavërteta apo të rreme në asnjë formular vetdeklarimi të cilat po të ishin evidente do të penalizoheshin sipas nenit 190/1 i Kodit Penal. Ky kolegji çmon se ekziston vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, pikërisht të aktit/dokumentit “kërkesë për aplikim” që është objekti material i veprës penale, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ligji nr. 84/2016 parashikon shprehimisht mënyrën dhe kriteret formale që duhet të plotësojnë anëtarët që do të përzgjidhen në institucionet për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve, si dhe procedurën që do të ndiqet nga organet publike të ngarkuara me këtë proces. Ligji me përzgjedhjen e kandidatëve ka ngarkuar Avokatin e Popullit, ndërsa në rregullimet e posaçme në këtë ligj janë përcaktuar afati për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacioni shoqërues, që duhet të dokumentojë që kandidati plotëson kriteret formale të përcaktuara në nenin 6 të ligjit. Ligji nuk ka parashikuar rregulla të tjera më të detajuara për aplikimin. Në këto rrethana, fakti që vetdeklarimi është parashtruar nga kërkuesi/aplikuesi Luan Daci në aktin “kërkesë/aplikim” dhe jo si një deklaram/vetdeklarim më vete, nuk cenon thelbin e deklaramit të tij se: *“Ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit.”*

38. Së treti, nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes për shuarjen e masës disiplinore të “largimit nga detyra”. Në lidhje me këtë pretendim, edhe ky kolegji i gjykatës së posaçme të apelit, si gjykata e shkallës së parë vlerëson se, ekzistenca e një mase të mëparshme të largimit nga puna, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, është një kriter përjashtues për t'u emëruar në pozicione të caktuara publike. Periudha kohore brenda të cilës masa disiplinore duhet të jetë në fuqi, në asnjë rast nuk lidhet me masën disiplinore të largimit apo shkarkimit nga detyra, por lidhet me masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji. Ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi, kanë theksuar pikërisht këtë konkluzion, ku në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”², në nenin 150 pika ‘3’ e tij, parashikohet shprehimisht që: *“masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri”*.

39. Në këto rrethana, bazuar në dispozitat ligjore të referuara më lart, pavarësisht periudhës kohore se kur është vendosur masa disiplinore e shkarkimit apo largimit nga detyra, ajo nuk konsiderohet e shuar. Si rrjedhojë, marrja e masës disiplinore “largim nga detyra” ndaj të pandehurit Luan Daci, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, neni 6 pika 1 germa “dh”, sjell si pasojë

²Botuar në fletoren zyrtare nr. 208, datë 07/11/2016, që ka hyrë në fuqi në datën 23/11/2016.

mosplotësimin e këtij kriteri ligjor e për pasojë moszgjedhjen e tij në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve.

40. Së katërti, mbrojtja dhe i pandehuri, pretenduan gjatë gjykimit në apel, se problemi i ekzistencës apo mosekzistencës së masës disiplinore në fuqi, është një çështje e interpretimit të ligjit dhe se, vlerësimi i bërë nga i pandehuri në lidhje me këtë fakt, është liri e mendimit dhe e vlerësimit të tij profesional. Ky vlerësim nuk mund të penalizohet, duke u cilësuar si vepër penale, pasi mungon një nga elementët kryesorë – faji që në këtë rast është në formën e dashjes direkte.

41. Nga aktet e përfshira në fashikullin e gjykimit, rezulton se në momentin që i pandehuri Luan Daci ka paraqitur kërkesën për t'u emëruar në një nga vendet vakante të shpallura nga ish-KLD në nëntor të vitit 2016, ka evidentuar edhe faktin se ka ushtruar funksionin e gjyqtarit. Eksperienca dhe përvoja e tij si gjyqtar është evidentuar edhe në jetëshkrimin e depozituar, në këtë rast. Nga ana tjetër, në kërkesën/aplikimin e depozituar në datë 03/02/2017 (vetëm disa muaj pas kërkesës së mësipërme) pranë institucionit të Avokatit të Popullit, i pandehuri nuk ka përfshirë në përvojën/eksperiencën e tij profesionale, faktin që ka ushtruar profesionin e gjyqtarit. Ky fakt nuk është pasqyruar as në jetëshkrimin e tij. Në vijim, ky kolegji çmon me rëndësi të evidentojë edhe faktin se, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar me secilin prej kandidatëve nga Komisioni në Kuvendin e Shqipërisë, në datë 02/06/2017, i pandehuri Luan Daci është pyetur në mënyrë të posaçme për përvojën e tij profesionale para vitit 2000.

42. Në shpjegimet e tij, i pandehuri me vullnetin e tij dhe me vetëdije të plotë, ka deklaruar se ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, duke u larguar me dorëheqje, pasi nuk e kanë përfshirë/regjistruar në programet e Shkollës së Magjistraturës. Pavarësisht, faktit që organet e ngarkuara me ligj për verifikimin e kandidaturave për në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve, nuk kanë kryer verifikimet përkatëse në konformitet me kërkesat e ligjit (fakt ky për të cilin prokuroria e posaçme nuk ka hetuar), kjo nuk e përjashton nga përgjegjësia të pandehurin, i cili me dashje dhe me vetëdije të plotë ka paraqitur në aplikimin e tij një rrethanë të rreme, duke fshehur një nga kriteret skualifikuese, që lidhet me ekzistencën e masës disiplinore të largimit/shkarkimit nga detyra të dhënë ndaj tij.

43. Qëllimi i të pandehurit shfaqet i qartë dhe i patjetërsueshëm. Ai ka fshehur ekzistencën e masës disiplinore “largim nga detyra” të dhënë ndaj tij, për të mos u skualifikuar nga kandidimi, siç kishte ndodhur pak muaj më përpara nga KLD. Këto rrethana tregojnë se, mosdeklarimi nuk është çështje e interpretimit të ligjit apo vlerësimi profesional i të pandehurit se kjo masë shumë e rëndë disiplinore është shuar, por këto rrethana provojnë kryerjen me dashje të një veprimi konkret që është fshehja e një fakti, duke paraqitur një rrethanë të rreme në një dokument – fakt ky që nga ligji cilësohet si vepër penale, “Falsifikim dokumenti”.

44. Së pesti, i pandehuri Luan Daci nuk mund të mbrohet me faktin se deklarimi apo jo i masës disiplinore “shkarkim nga detyra” është çështje e interpretimit të ligjit nga ana tij. Ky pretendim është në kundërshtim me veprimet e kryera nga vetë i pandehuri, i cili kur ka aplikuar për t'u riemëruar si gjyqtar, vend ky për të cilin kishte rëndësi kualifikuese, përvoja e mëparshme në gjyqësor, të cilën ai e ka evidentuar si në jetëshkrim, ashtu edhe në kërkesë për tu emëruar sërish si gjyqtar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky element tregon se, ai me vetëdije të plotë dhe me dashje ka fshehur një të dhënë të rëndësishme, duke paraqitur rrethana të rreme si në aplikimin e depozituar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, ashtu edhe në jetëshkrimin e tij. Fakti i mos përmendjes në jetëshkrim se ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, si dhe deklarimi në seancën dëgjimore përpara Komisionit në Kuvendin e Shqipërisë, të datës 02/06/2017 ku ka shpjeguar se është larguar me dorëheqje, mbështesin konkluzionin e Prokurorisë së Posaçme dhe të Gjykatës së Posaçme të shkallës së parë, se rrethana e rreme e deklaruar prej tij në aplikimin/kërkesën e datës 03/02/2017 në pikën f) të saj, është deklaruar me dashje direkte dhe me qëllimin për të fshehur faktin se ndaj tij është marrë masa disiplinore “largim/shkarkim nga detyra”.

45. Së gjashti, kolegji vlerëson se provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, fajësia e të pandehurit Luan Daci, i cili me dashje direkte, ka fshehur/nuk ka deklaruar një të dhënë skualifikuese në aktet e paraqitura prej tij, konkretisht në dokumentin aplikim/kërkesë, si dhe në jetëshkrimin profesional të tij. Bazuar në arsyet e trajtuara më lart, ky kolegji vlerësoi të pabazuar në prova, pretendimin e mbrojtjes se i pandehuri nuk ka vepruar me dashje, pasi nuk kishte dijeni që mosreferimi i përvojës profesionale si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, do të përbënte shkak për fillimin e procedimit penal ndaj tij.

46. Aplikimi/kërkesa e depozituar nga i pandehuri në datë 03/02/2017, është një akt/dokument i përpiluar prej tij, ku falsifikimi i përmbajtjes qëndron në mosdeklarimin e një fakti, duke pasqyruar një rrethanë të rreme në lidhje me përvojën e tij profesionale si gjyqtar dhe faktin e largimit nga ushtrimi i këtij profesioni, për shkelje shumë të rënda. Në këtë vështrim, kolegji i gjykatës së posaçme të apelit, vlerëson haptazi të pabazuara pretendimet e të pandehurit dhe mbrojtësve të tij se vepra penale nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë, pasi nuk është paraqitur asnjë e dhënë e pasaktë në këtë kërkesë. Në fakt, siç u argumentua edhe në këtë vendim, me dashje e vetëdije i pandehuri Luan Daci, jo vetëm që nuk ka deklaruar një fakt me rëndësi për procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, por edhe ka pohuar faktin e rremë se është larguar me dorëheqje nga funksioni i gjyqtarit.

47. I pabazuar në prova vlerësohet nga ky kolegji edhe pretendimi tjetër se nuk ka qenë në dijeni të masës disiplinore “largim/shkarkim nga detyra” dhënë ndaj tij nga KLD në vitin 1997, kur provohet se ai ka qenë i pranishëm në mbledhje dhe ka kundërshtuar kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për largimin e tij nga detyra. Edhe pretendimi tjetër, se në vitin 2016 nuk është njoftuar për arsyen e mospranimit të kërkesës së tij për t’u rriemëruar gjyqtar nuk qëndron.

48. **Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs, në datën 20.04.2021, kërkuesi Luan Daci** me anë të së cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit nr. 5 datë 08.03.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim duke vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të të dënuarit Luan Daci dhe deklarimin e tij të pafajshëm për veprën penale “Falsifikimi dokumenteve” të parashikuar nga neni 186/1 të Kodit Penal, për shkak se del qartë se fakti penal nuk përbën vepër penale dhe në thelb as nuk ekziston.*

49. Në rekurs kërkuesi, ka parashtruar të njëjtat shkaqe si në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë ashtu dhe në ankimin e paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit. Në rekurs i gjykuari ndër të tjera, ka parashtruar se:

- Masa ndaluese e sigurimit personal “Pezullim i ushtrimit të detyrës” është dhënë në kundërshtim me ligjin pasi z. Luan Daci gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe shkeljet disiplinore të tij shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit. Gjithashtu, ky gjyqtar ka statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe mund të pezullohej nga detyra vetëm me vendim të Gjykatës Kushtetuese ose Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
- Masa disiplinore e dhënë ndaj shtetasit Luan Daci është shuar, pasi kjo masë disiplinore sipas nenit 9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” shuhej brenda 3 viteve ndaj data e dhënies së saj, nëse pas saj nuk është dhënë masë tjetër disiplinore.
- Vepra penale për të cilën akuzohet subjekti nuk ekziston për sa kohë masa disiplinore e dhënë ndaj tij është shuar, pra ky shtetas ka thënë të vërtetën, prandaj mungon ana objektive e kësaj vepre penale.
- Kërkesa për kandidim është një dokument i njëanshëm i cili nuk është një fakt juridik që shënon momentin e lindjes, ndryshimit ose shuarjes së marrëdhënies juridike. Organi që merr kërkesën nuk është i detyruar ta vlerësojë dhe as të marrë të mirëqenë ndonjë nga faktet që parashtrohen në të.

- I pandehuri Luan Daci është dënues pa ligj pasi Kodi ynë Penal nuk parashikon veprën penale të falsifikimit ideologjik dhe jo intelektual siç e kanë quajtur akuza dhe gjykata.
- Gjykata ka anashkaluar faktin që përmbajtja e kërkesës së bërë nga Luan Daci ishte e lirë të përcaktohej nga vetë ky shtetas dhe se plotësimi ose jo i kriterëve nuk kishte të bënte me përmbajtjen e saj por me verifikimin që duhet të bëhet nga organet kompetente.
- Gjykata i ka atribuar kërkesës vlerën e shkresës private sipas K.Pr.Civile dhe ky paralelizëm ose analogji nuk qëndron, pasi Kodi Penal ndalon zbatimin e ligjit penal me analogji. Në këtë rast, jemi para një dokumenti privat por që paraqitet dhe përdoret në një procedurë administrative.
- Gjykata në mënyrë absurde dhe krejt me qëllim ngatërron elementët e domosdoshëm të përmbajtjes së një akti si kusht për vlefshmërinë e tij sipas K.Pr.Administrative dhe elementëve të figurës së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve.
- Prokuroria ka hetuar jashtë kompetencave të caktuara në kundërshtim me nenin 277 të K.Pr.Penale. Fakti penal i pretenduar nga prokuroria për të cilin keni filluar procedimin nuk parashikohet në ligj si vepër penale dhe del qartë se fakti penal nuk ekziston në kuptim të germave ç) dhe e) të nenit 290 të K.Pr.Penale dhe germave a), b) të nenit 328 të K.Pr.Penale.
- Dëshmitë e të tre punonjësve të Avokatit të Popullit, (si organ ndihmës) përpara Gjykatës së Faktit, konfirmuan qartë se e dhëna e pretenduar si e mohuar nga akuza ndaj aplikuesit Luan Daci, që lidhet me kriterin e Nenit 6/1/dh të ligjit nr. 84/2016, nuk është kërkuar në asnjë formular vetdeklarimi dhe z. Luan Daci nuk kishte ku ta deklaronte këtë të dhënë.
- Pra, një e dhënë e pakërkuar nuk ka ku të deklarohet dhe siç theksuam edhe më sipër, kjo e dhënë, ky interpretim i qenies apo mosqenies në fuqi të një mase disiplinore, si fakt nuk ka asnjë lidhje me përmbajtjen e Nenit 186/1 të Kodit Penal. Interpretimi është një e drejtë diskrecionare, ndërsa falsifikimi i dokumenteve është veprim krejt i ndryshëm nga interpretimi, pasi falsifikimi i dokumenteve lidhet vetëm me veprime aktive ndryshuese mbi të dhënat zyrtare të dokumentit zyrtar.
- Kërkesa nuk është një akt që të ketë lidhje kauzale (shkak-pasojë) me emërimin në këto funksione të organeve të rivlerësimit. Kjo kërkesë, ky akt jozyrtar, nuk rezulton të jetë tjetërsuar, të jetë ndryshuar vullneti i aplikuesit Luan Daci në këtë procedurë administrative. Ky akt individual i aplikuesit është autentik dhe nuk ka asnjë lidhje me nenin 186/1 të Kodit Penal.
- Fajësia për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve është e lidhur qartësisht me faktin penal të kërkuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, i cili kërkon shprehimisht ekzistencën e një dokumenti zyrtar, me të dhëna zyrtare të falsifikuara në të. Nuk jemi para ndonjë fakti të tillë penal, nuk ka vepër penale.
- Vendimi ndaj të cilit jemi ankuar ka shkelur të drejtën kushtetuese për proces të rregullt të kërkuarit, e cila kërkon që vendimi t'ju jepte përgjigje të arsyetuar lidhur me provat dhe faktet juridike që provonin secila prej tyre ose veç e veç, si dhe t'ju jepte përgjigje të arsyetuar se përse pretendimet e gjykatës ishin të saktë dhe se provat e ndodhura në dosje dhe argumentet e palës kërkuar nuk ishin të sakta dhe nuk duheshin të pranoheshin.
- Gjykata e Apelit në fakt ka zgjedhur të jap përgjigje vetëm për disa dhe jo për të gjithë pretendimet thelbësore dhe nga ana tjetër u ka dhënë përgjigje duke kopjuar dhe cituar fjalë për fjalë Gjykatën e Apelit. Pra nuk ushtron në thelb detyrën që i ngarkon ligji për të kontrolluar ligjshmërinë e vendimit të shkallës parë, kjo pasi në arsyetim ajo duhet të arsyetojë edhe pse pala ankuar nuk ka të drejtë dhe përse vendimi i gjykatës së shkallës parë është i drejtë jo duke përsëritur fjalët e kësaj të fundit, por duke arsyetuar përtej atyre fjalëve. Në rast të kundërt për çfarë do të duhej ekzistenca e gjykatës së apelit?! Pra kjo e

fundit nuk ka vepruar si gjykatë e pavarur, profesionale dhe e krijuar me ligj dhe ka shkelur garancitë thelbësore të një procesi të rregullt.

- Këto kërkesa ligjore thelbësore nuk kanë marrë asnjë përgjigje të arsyetuar sikurse parashikon ligji. Për rrjedhojë vendimi ndaj të cilit po ankohe mi ka cenuar të drejtën për proces të rregullt të garantuar nga neni 6 i Konventës Evropiane dhe neni 42 i Kushtetutës së RSH. Kjo pasi të dy këto nene dhe veçanërisht Neni 6 i KEDNJ kërkon që të gjitha gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre si civile ashtu edhe penale.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Kërkesa për përsheptimin e shqyrtimit të rekursit

50. Në lidhje me çështjen e përsheptimit të shqyrtimit të rekursit janë paraqitur dy kërkesa të veçanta, njëra prej Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe tjetra prej të gjykuarit Luan Daci. Të dy kërkuesit parashitrojnë në kërkesë nevojën që kjo çështje të gjykohet me përparësi nga Gjykata e Lartë, për shkak që lidhen me mos pengimin e veprimtarisë dhe funksionimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në drejtim të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Të njëjtin mendim ka shprehur edhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit në kërkesën drejtuar Gjykatës së Lartë.

51. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (referimi i mëposhtëm Kolegji) ka vlerësuar që çështjen objekt gjykimi ta marrë në shqyrtim me përparësi dhe tej rregullit të përgjithshëm që parashikon shqyrtimin e rekurseve, referuar datës së regjistrimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të rëndësisë dhe të interesit publik që ajo mbart. Pa lënë mënjanë rëndësinë që ka çdo çështje e depozituar në Gjykatën e Lartë, vlerësohet se një çështje e tillë paraqet në vetvete një nevojë të madhe publike për shpejtësi gjykimi, për arsye se kërkuesi Luan Daci ka qenë në detyrën e Gjyqtarit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, një nga institucionet e parashikuara nga Kushtetuta, për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Për shkak të rëndësisë dhe rolit të pazëvendësueshëm që ka Kolegji i Posaçëm i Apelimit në mbarëvajtjen e reformës në drejtësi, që është një proces thelbësor për ecurinë e sistemit gjyqësor shqiptar dhe që ky proces të përmbillet sa më shpejt, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja e punës në sistemin gjyqësor në vend dhe të realizohet në kohë dhënia e drejtësisë, Kolegji Penal vendosi të shqyrtojë këtë çështje me përparësi.

52. Në vijim, Kolegji evidenton faktin e ndryshimeve ligjore që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi në datën 29.05.2021. Në nenin 38 të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore parashikohet se: *“1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekursi e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre”*. Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

53. Kolegji vlerëson se rekursi është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale. Rekursi është nënshkruar prej kërkuesit dhe mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është njoftuar për rekursin.

54. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, parashikon se *Rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose*

është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

55. Kolegji vë në dukje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në të gjitha rastet kur rekursi nuk i përmbahet shkaqeve të përcaktuara nga neni 432/1 i Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal vendos mospranimin e rekursit. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

56. Kolegji Penal vlerëson se asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk i referohet shkaqeve të rekursit të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Pavarësisht se Kolegji Penal nuk i hyn vlerësimit të provave në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi i çështjes referuar shkaqeve të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, nuk rezulton që të ketë shkaqe për cenimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kolegji vlerëson se nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është zbatuar drejtë ligji material dhe ai procedural si dhe vendimmarrja e kësaj gjykate nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, shkaqe këto që do ta bënin të cenushme vendimmarrjen e saj.

57. Fillimisht Kolegji çmon se shkaqet e rekursit janë të njëjta me pretendimet e ngritura në gjykimin në shkallë të parë dhe me shkaqet e ankimit të paraqitura pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kolegji konstaton se kërkuesi ka marrë përgjigje të argumentuar në të dyja shkallët e gjykimit për të njëjtat shkaqe që ai i ka ngritur në rekurs pranë Gjykatës së Lartë.

58. Së pari, Kolegji vë në dukje se pretendimet në lidhje me zbatim të gabuar të fakteve dhe provave nuk merren në shqyrtim nga Kolegji, pasi Gjykata e Lartë është një gjykatë ligji, që i shqyrton çështjet referuar shkaqeve të rekursit të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale. Qenia si gjykatë ligji kushtëzohet me faktin se Gjykata e Lartë nuk është një gjykatë që shqyrton çështjen penale si shkallë e tretë gjykimi, por ajo është gjykatë që shqyrton vetëm pretendimet e palëve për zbatim të gabuar të ligjit material apo procedural me pasojat ligjore të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, ose kur vendimi objekt rekursi bie në kundërshtim me vet praktikën e Gjykatës së Lartë. Faktet Kolegji i shqyrton ashtu siç ato rezultojnë të provuara nga gjykatat më të ulëta, që janë gjykata fakti.

59. Me ndryshimet e K.Pr.Penale të miratuara me ligjin nr. 41/2021 rezulton se rekursi duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve të nenit 432 të këtij Kodi. Paraqitja e rekursit për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit, apo pa u argumentuar, përbëjnë shkak që Kolegji të vendosë mospranim të rekursit sipas nenit 433 të K.Pr.Penale që parashikon se: *“Rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, si dhe kur Gjykata e Lartë çmon se çështja nuk duhet të shqyrtohet prej saj, sipas përcaktimeve të paragrafit 1, të nenit 432, të këtij Kodi.”*

60. Kolegji çmon se në rastin konkret nuk rezulton që kërkuesi të ketë argumentuar nëse nga gjykatat më të ulëta ka pasur zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, apo nëse vendimet e gjykatave më të ulëta bien në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal apo Gjykatës së Lartë (*Shih vendimin nr. 70003-551-2021 regjistri themeltar datë 23.07.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

61. Pavarësisht sa më sipër, Kolegji çmon t'i kthejë përgjigje disa prej pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi Luan Daci, duke veçuar ato pretendime që meritojnë vëmendje të veçantë prej Kolegjit.

Për pretendimin për masën ndaluese

62. Në lidhje me pretendimin e ngritur për masën ndaluese të dhënë ndaj kërkuesit, Kolegji vlerëson se ajo nuk përbën çështje objekt të këtij gjykimi, por të një gjykimi tjetër me objekt caktimin e masës ndaluese ndaj shtetasit Luan Daci, që do të shqyrtohet sipas radhës nga trupa e Kolegjit Penal caktuar me short për këtë qëllim. Ndaj vendimit të Gjykatave të Posaçme për caktimin e masës së sigurimit me natyrë ndaluese për shtetasin Luan Daci është ushtruar rekurs i veçantë prej tij, i cili shqyrtohet nga një trupë tjetër gjyqësore e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Për pretendimin e shuarjes së masës disiplinore të “shkarkimit nga detyra”

63. Në lidhje me pretendimin se masa disiplinore “shkarkim nga detyra” dhënë ndaj subjektit Luan Daci është shuar, Kolegji, ashtu si gjykatat më të ulëta, e gjen të pabazuar. Kolegji mbështet tërësisht arsyetimin e gjykatave më të ulëta se ekzistenca e një mase të mëparshme të largimit nga puna, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, është një kriter përjashtues për t'u emëruar në pozicione të caktuara publike. Periudha kohore brenda të cilës masa disiplinore duhet të jetë në fuqi, në asnjë rast nuk lidhet me masën disiplinore të largimit apo shkarkimit nga detyra, por lidhet me masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji. Ekzistenca e një mase të mëparshme të largimit nga detyra, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, është një kriter përjashtues për t'u emëruar në pozicione të caktuara publike. Periudha kohore brenda të cilës masa disiplinore duhet të jetë në fuqi, në asnjë rast nuk lidhet me masën disiplinore të largimit apo shkarkimit nga detyra, por lidhet me masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji. Ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi, kanë theksuar pikërisht këtë përfundim, ku më konkretisht në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”³, në nenin 150, pika 3 të tij, parashikohet shprehimisht që: “masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri”.

64. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se interpretimi i bërë nga kërkuesi se masa disiplinore e dhënë ndaj shtetasit Luan Daci është shuar, pasi kjo masë disiplinore sipas nenit 33 të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” shuhej brenda 3 viteve nga data e dhënies së saj, nëse pas saj nuk është dhënë masë tjetër disiplinore, është i pabazuar në ligj. Neni 33 i ligjit të mësipërm parashikon shuarjen brenda 3 viteve të masave disiplinore të rënda, ndërsa për masat disiplinore shumë të rënda siç është ajo e shkarkimit nga detyra nuk parashikohej shuarja. Rrjedhimisht pretendimi i kërkuesit për shuarjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra si gjyqtar” të dhënë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë më datë 24. 12.1997 është i pambështetur në ligj.

Për pretendimin e mungesës së elementit të fajit

65. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se mungon elementi faj, Kolegji vlerëson se gjykatat më të ulëta kanë arsyetuar në mënyrë bindëse dhe shteruese ekzistencën jo vetëm të fajit, por të të gjitha elementeve të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Faji, si element i anës subjektive, ekziston në rastin konkret, pasi ka rezultuar e provuar se kërkuesi ka pasur dijeni për masën disiplinore të “shkarkimit nga detyra e gjyqtarit” dhënë ndaj tij nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Njëkohësisht kërkuesi Luan Daci ka pasur dijeni që kjo masë përbënte kriter skualifikues nga pozicioni i punës ku ai po aplikonte dhe me dashje dhe vetëdije të plotë e ka fshehur atë në kërkesën e tij për aplikim me shkrim drejtuar institucionit të

³Botuar në fletoren zyrtare nr. 208, datë 07/11/2016, që ka hyrë në fuqi në datën 23/11/2016.

Avokatit të Popullit duke paraqitur në kërkesë rrethanën e rreme se ndaj tij nuk është marrë asnjë masë e largimit të tij nga detyra.

66. Nga tërësia e fakteve të vlerësuara si të provuara nga gjykatat më të ulëta, ka rezultuar se kërkuesi Luan Daci ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë përgjatë viteve 1993-1997. Ky shtetas është larguar nga detyra për shkak se ndaj tij është dhënë masa disiplinore “Shkarkim nga detyra si gjyqtar”, masë disiplinore për të cilën kërkuesi ka pasur dijeni të plotë. Rezulton se një fakt të tillë, pra funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ky shtetas e ka deklaruar në një aplikim të bërë në vitin 2016 pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për t’u emëruar gjyqtar. Në atë kohë shtetasi Luan Daci është skualifikuar në aplikimin e tij për tu emëruar gjyqtar, pikërisht për shkak të faktit se më parë Këshilli i Lartë i Drejtësisë kishte marrë masën disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra si gjyqtar.

67. Për të vijuar më tej, në datën 02.03.2017 shtetasi Luan Daci ka paraqitur kërkesë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me objekt “Për aplikimin, emërimin e kërkuesit në vendet vakante të shpallura në bazë të ligjit nr. 84/2016”. I gjykuari ka aplikuar për t’u emëruar në vendin vakant a) Gjyqtar i Kolegjit të Apelimit; b) Anëtar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; c) Komisioner publik. Në jetëshkrimin e tij ky shtetas nuk ka deklaruar faktin që ka qenë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa është detyruar ta deklarojë këtë fakt kur është pyetur në intervistën e dhënë pranë Komisionit të ngritur nga Kuvendi për verifikimin e kandidaturave. Në këtë Komision ky kandidat edhe pse ka pranuar se ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka fshehur shkakun e largimit nga ky pozicion duke u shprehur se: *“Unë kam ikur me dorëheqje, sepse nuk na lejuan të regjistroheshim”*.

68. Kolegji vlerëson se kërkuesi në këtë mënyrë me dashje ka parashtruar një rrethanë të rreme në kërkesën e tij për shprehje interesi, rrethanë që i referohet situatës që ai nuk kishte marrë asnjëherë masën disiplinore të largimit nga detyra. Duke paraqitur rrethanën e rreme në kërkesën e tij, i gjykuari Luan Daci ka përfituar prej saj, pasi me vendimin nr. 82/2017, datë 17.06.2017, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ai është zgjedhur Gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, një nga institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

69. Sa më sipër, Kolegji e gjen të drejtë arsyetimin e gjykatave më të ulëta se i gjykuari Luan Daci ka paraqitur me vetëdije të plotë të dhëna të rreme në aplikimin e tij si kandidat për pozicionin gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pozicion në të cilin u kualifikua dhe u emërua pikërisht për shkak të të dhënave të pavërteta që ai paraqiti në kërkesën e tij. Nëse kërkuesi do ta kishte paraqitur në kërkesë rrethanën e shkarkimit nga detyra e gjyqtarit në vitin 1997, ai do të rrezikonte skualifikimin për shkak të ligjit nga kandidimi si anëtar i Organeve Kushtetuese të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Kolegji vlerëson se i gjykuari ka vepruar me faj kur ai ka paraqitur rrethanën e rreme në kërkesën për shfaqje interesi se ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna.

70. Mungesa e veprimit të organeve të ngarkuara nga ligji nr. 84/2016, “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në drejtim të verifikimit të kushteve që duhet të plotësonin kandidatët për anëtarë të institucioneve të rivlerësimit, nuk përjashton përgjegjësinë e kërkuesit për deklarimin e të dhënave të rreme në kërkesën për kandidim të paraqitur prej tij. Në rastin konkret paraqitja e rrethanave të rreme në kërkesën drejtuar Avokatit të Popullit, shkakton përgjegjësi penale për të gjykuarin.

Për pretendimin se kërkesa nuk përbën akt zyrtar

71. Në lidhje me pretendimin se aplikimi/kërkesa e kërkuesit Luan Daci nuk përbën akt zyrtar dhe mungon objekti i veprës penale të falsifikimit, Kolegji vlerëson se edhe në lidhje me këtë pretendim kërkuesi ka marrë përgjigje të plotë dhe të qartë nga vendimet e gjykatave më të ulëta, arsyetim që gjendet i drejtë dhe shterues nga Kolegji.

72. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vlerëson të evidentojë elementet e objektit dhe anës objektive të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për sa kohë këto elemente janë parashtruar në mënyrë implicite në rekursin e të gjykuarit që i referohet pretendimit se kërkesa e tij nuk përbën akt zyrtar.

73. Objekti veprës penale të falsifikimit të dokumenteve është marrëdhënia juridike konkrete që garanton veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike, si dhe të personave privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumenteve nga veprimet kriminale. Në këtë kuptim, objekt i falsifikimit sipas nenit 186 të Kodit Penal nuk mund të jenë vetëm aktet zyrtare sikundër pretendon kërkuesi, por janë dokumentet ku përfshihen si aktet zyrtare ashtu edhe ato private.

74. Dokumenti në vetvete përfaqëson aktet zyrtare dhe aktet private, të cilat jo vetëm që duhet të plotësojnë disa elemente minimale formale si identiteti i përpiluesit dhe të pranishmëve, data, përmbajtja dhe nënshkrimi, por që më tej në përmbajtjen e tyre, duhet të dokumentojnë juridikisht ekzistencën e ngjarjes apo marrëdhënies së caktuar, të cilën përpiluesi i saj në rrethana të parashikuara nga ligji ka detyrimin ligjor të pasqyrojë të vërtetën. Është e vërtetë që kërkesa/aplikim e hartuar nga i gjykuari Luan Daci nuk është akt zyrtar pasi ajo nuk është nxjerrë nga një organ publik apo institucion shtetëror, por në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal ajo është dokument për sa kohë kërkesa/aplikim është shprehje e një kriteri ligjor dhe sjell pasoja juridike në bazë të nenit 6 dhe 7 të Ligjit nr. 84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

75. Në lidhje me nocionin e “falsifikimit” në Kodin Penal nuk jepet përkufizim, por përgjithësisht është pranuar nga jurisprudenca se me falsifikim në vetvete do të kuptojmë paraqitjen në një dokument të rrethanave të rreme, që kryhet nëpërmjet ndryshimit mekanik të dokumentit ekzistues, falsifikimit material, ose përpilimin e një dokumenti krejtësisht të falsifikuar, ndryshe falsifikimi intelektual.

76. Nga ana objektive falsifikimi i dokumenteve, mund të kryhet në dy forma: (i) nëpërmjet “falsifikimit të dokumenteve”, ose (ii) nëpërmjet “përdorimit të dokumenteve të falsifikuara” nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij. Në formën e parë të kryerjes së kësaj vepre, është e domosdoshme zbulimi i autorësisë së veprimit të falsifikimit për konfigurimin e kësaj forme të kryerjes së veprës penale, ndërsa në formën e dytë, rëndësi ka identifikimi i përdoruesit të dokumentit të falsifikuar.

77. Falsifikimi ideologjik ose intelektual mbi një dokument quhet i realizuar në rastin kur një rregull i caktuar i parashikuar në ligj i atribuon autorit të veprës penale detyrimin e vërtetimit të fakteve në dokumentin që duhet të hartohet prej tij. Në këtë rast hartuesi i dokumentit është i ngarkuar nga ligji për të deklaruar të vërtetën në dokumentin e tij.

78. Neni 6, paragrafi i parë, germa “dh” i ligjit nr. 84/2016, “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcaktonte kriterin ligjor që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit përzgjidheshin personat ndaj të cilëve organet disiplinore nuk kishin marrë më parë masa të largimit nga puna. Përcaktimi ligjor i parashikuar në nenin 6 të këtij ligji për mospasjen e masës disiplinore të largimit nga puna ishte një kriter kualifikimi për kandidatët që kishin shfaqur interesin e tyre për anëtarë të institucioneve të rivlerësimit. Është e kuptueshme se ligji “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në kriteret e parashikuara në nenin 6 të tij synonte të përzgjidhte anëtarët e institucioneve të rivlerësimit që gëzonin integritet të lartë moral dhe profesional.

79. Kërkesa e paraqitur nga i gjykuari Luan Daci ku ai kishte shprehur interesin e tij për të kandiduar si anëtar i institucioneve të rivlerësimit është dokument ligjor në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal. Me të drejtë gjykatat më të ulëta e kanë vlerësuar kërkesën e paraqitur nga i gjykuari Luan Daci si dokument ligjor në të cilin janë paraqitur rrethana të rreme nga i gjykuari. Paraqitja e kërkesës për shfaqje interesi nga kandidatët, si dhe ndër të tjera, përfshirja e rrethanës që ndaj tyre

nuk ishte marrë masa e largimit nga puna, ishte një kriter ligjor që nuk mund të shmangej nga kandidatët. I gjykuari Luan Daci jo vetëm që i është shmangur këtij detyrimi, por ai ka shkuar edhe të tej, pasi në kërkesë ai ka paraqitur rrethanën e pavërtetë që ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga detyra.

80. Kolegji, duke konfirmuar qëndrimin e mbajtur nga gjykatat më të ulëta, arrin në përfundimin se kërkesa për shfaqje interesi e hartuar dhe paraqitur nga i gjykuari Luan Daci është një dokument ligjor në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal. Në këtë kërkesë i gjykuari ka paraqitur rrethanën e rreme se ndaj tij nuk ishte marrë masa disiplinore e largimit nga puna. Rrjedhimisht kërkesa si dokument ligjor është e falsifikuar nga i gjykuari.

Për pretendimin e dënimit të kërkuarit pa ligj

81. Kërkuari, në rekurs, është shprehur se legjislacioni penal nuk e parashikon rastin e falsifikimit intelektual ose ideologjik në veprën penale të falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në lidhje me këtë pretendim Kolegji konfirmon qëndrimin e mbajtur nga gjykatat më të ulëta të cilat janë shprehur se kërkesa për shprehje interesi e hartuar nga i gjykuari është dokument i falsifikuar në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal në mënyrën e falsifikimit intelektual ose ideologjik. Jurisprudenca e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka njohur dhe analizuar metodën e falsifikimit intelektual si një nga mënyrat e kryerjes së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Për falsifikimin intelektual Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2017-581 i Vendimit (111), datë 12. 07. 2017, shprehet se:

*“...Falsifikimi intelektual kryhet me anë të krijimit tërësisht të aktit, dokumentit, me anë të të cilit një subjekt fizik apo juridik, publik ose privat, shpreh vullnet, merr përsipër të drejta dhe detyrime, të cilat realisht nuk i ka shprehur...”*⁴

...
*“...Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve si njëra nga format kryerjes e përmendur më sipër, mund të bëhet në dy mënyra: ose duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi dokumentin, duke i bërë shtesa a tjetërsime të paligjshme, apo me çdo veprim tjetër material një dokumenti ekzistues të mëparshëm. Në këtë rast, do të ndodhemi përpara falsifikimit “material”; apo në mënyrën tjetër që konsiston në falsifikimin e përmbajtjes së dokumentit, pa prekur formën e tij, duke ndryshuar konceptin dhe brendinë e dokumentit. Në këtë rast, kemi të bëjmë me falsifikim “intelektual” që cenon pjesën përshkruese-dëftuese të dokumentit...”*⁵

82. Rrjedhimisht, pretendimi i të gjykuarit se ai është i dënuar pa ligj nuk qëndron pasi ai nuk gjen mbështetje në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë në praktikën e saj gjyqësore ka pranuar metodën e falsifikimit intelektual si një nga mënyrat e realizimit të veprës penale të falsifikimit të dokumentit të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Për pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor

83. Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit i ka cenuar kërkuarit procesin e rregullt ligjor, pasi nuk i ka kthyer përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuarit dhe nuk ka arsyetuar vendimmarrjen e saj, Kolegji e gjen të pabazuar. Kolegji vlerëson se Gjykata e Posaçme e Apelit ka shqyrtuar dhe analizuar në vendimin e saj të gjitha pretendimet e ngritura në ankim nga kërkuari, pretendime që edhe pse kanë marrë përgjigje, janë ngritur sërish si shkaqe rekursi në Gjykatën e Lartë. Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e ngritur në rekurs se gjykata e apelit ka përsëritur arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit ka arsyetuar në të njëjtën linjë

⁴Faqe nr. 8, paragrafi i 3-të, i Vendimit të Gjykatës së Lartë

⁵ Faqe nr. 9, paragrafi i 4-ët i Vendimit të Gjykatës së Lartë

si gjykata e shkallës së parë, duke konfirmuar argumentimin dhe përfundimin e arritur nga gjykata e shkallës së parë. Për këto arsye, edhe pretendimi për cenim të procesit të rregullt ligjor nga kjo gjykatë nuk qëndron.

84. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga kërkuesi Luan Daci kundër vendimit nr. 5, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk përmban ndonjë shkak ligjor të kërkuar nga neni 432 i K. Pr. Penale dhe për rrjedhojë ai nuk pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I :

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Luan Daci kundër vendimit nr. 5, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 26.10.2021

A N Ë T A R
(kundër)
Asim VOKSHI

A N Ë T A R
Klodian KURUSHI

K R Y E S U E S
Ilir PANDA

MENDIM PAKICE

(i gjyqtarit Asim VOKSHI)

“Nullum crimen, nulla poena sine lege”

1. Në çështjen penale të gjykuar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë me nr. 53801-461-2021, datë regjistrimi: 08.06.2021, datë vendimi 26.10.2021 që i përket:

Kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë
I dënuar/rekursues: Luan Daci.
Dënuar: Për kryerjen e veprës penale *“Falsifikim i dokumenteve”*, parashikuar nga neni 186(1) i Kodit Penal.

2. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi më datë 26.10.2021 shumica vendosi:

“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Luan Daci kundër vendimit nr.5, datë: 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”

3. Duke qenë kundër vendimmarrjes së mësipërme të shumicës së trupit gjykues, të cilën e vlerësoj ligjërisht të gabuar, çmoj të parashitroj përmbledhtazi në vijim arsyet në të cilat mbështes mendimin tim të mbetur në pakicë, me bindjen e brendshme se ashtu siç thoshte edhe William Penn (1644-1718) rreth tre shekuj më parë “[e] drejta është e drejtë, edhe nëse të gjithë janë kundër saj, dhe e gabuara është e gabuar, edhe nëse të gjithë janë në favor të saj.”

4. Unë gjyqtari i mbetur në pakicë vlerësoj se midis alternativave të ndryshme të vendimmarrjes në Gjykatën e Lartë që parashikon neni 441 i Kodit të Procedurës Penale, shumica zgjodhi atë më pak të përshtatshmen për rastin konkret. Duke vendosur mospranimin e rekursit shumica zgjodhi të mos e gjykojë në themel çështjen, ndonëse ajo në vetvete paraqet një rast të rëndësishëm të zbatimit të keq të ligjit nga gjykatat më të ulta, që është themelor për zhvillimin e praktikës gjyqësore dhe parandalimin e precedentit të dënimit penal pa ligj. Kjo pasi, në rastin konkret objekt gjykimi pakica vlerëson se rekursuesi Luan Daci është deklaruar fajtor dhe është dënuar për një sjellje që nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Për këtë arsye jam i mendimit se Gjykata e Lartë, në zbatim të neneve 441(1)(d) dhe 442(1)(a) të Kodit të Procedurës Penale duhej të kishte prishur vendimin nr.5, datë: 08.03.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimin nr.32, datë: 01.12.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të pushonte gjykimin e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim, për shkak se fakti për të cilin është deklaruar fajtor dhe dënuar rekursuesi Luan Daci, nuk përbën vepër penale.

5. Neni 7 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj) ka përcaktuar se:

“1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk

mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.”

6. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), garancitë që përmban neni 7 i KEDNj, i cili është pjesë themelore e konceptit të shtetit të së drejtës, zënë një vend të rëndësishëm në sistemin mbrojtës të Konventës, siç përcaktohet edhe nga fakti se asnjë derogim nuk lejohet sipas nenit 15 të Konventës, në kohë lufte apo emergjence tjetër publike. Neni 7 i KEDNj duhet kuptuar dhe zbatuar, siç rrjedh nga objekti dhe qëllimi i tij, në mënyrë të tillë që të japë garanci efektive kundër ndjekjes penale, deklarimin fajtor dhe dënimin penal arbitrar [*shih vendimet e GjEDNj në çështjet (S.W. k. Mbretërisë së Bashkuar, § 34; C.R. k. Mbretërisë së Bashkuar, § 32; Del Río Prada k. Spanjës [DhM], § 77; Vasiliauskas k. Lituanisë [DhM], § 153).*]

7. Gjykatat e faktit kanë bërë një vlerësim aq të gjerë të nenit 186(1) të Kodit Penal, sa praktikisht kanë kriminalizuar çdo lloj shkrese private që mund të përmbajë të dhëna “false”, pa marrë parasysh juridikisht natyrën, qëllimin, funksionin dhe efektin e “dokumentit” në fjalë, i cili në çdo rast duhet parë në përputhje me legjislacionin përkatës administrativo-publik që e rregullon atë. A është ky qëllimi dhe objekti i nenit 186 të Kodit Penal? Mendoj se jo dhe vlerësoj se kjo qasje e gjykatave më të ulta bie ndesh me përcaktimin e nenit 29(1) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: “1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj...” Vepra penale e “falsifikimit të dokumenteve” sipas nenit 186 të Kodit Penal, nuk mund të interpretohet në mënyrë aq të gjerë sa kanë arsyetuar gjykatat më të ulta, e të përfshijë faktet e kësaj çështje. Në zbatim të nenit 7(1) të KEDNj është me rëndësi themelore të analizohet nëse veprimet apo mosveprimet e rekursuesit Luan Daci, futeshin apo jo në sferën e veprimit të nenit 186(1) të Kodit Penal dhe jo nëse ekzistonte apo jo në Kodin Penal një dispozitë penale që dënonte falsifikimin e dokumenteve. Për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje dhe parandalimin e procedimeve, gjykimeve dhe dënimeve penale arbitrare në të ardhmen, vlerësoj se ishte e rëndësishme që Gjykata e Lartë të analizonte aspektet ligjore dhe logjike vijuese.

8. Gjykata e Lartë duhej të analizonte dhe të jepte përgjigje në lidhje me llojin e sjelljeve që kriminalizon neni 186 i Kodit Penal, për të cilin gjykatat e faktit kanë deklaruar fajtor dhe dënuar rekursuesin Luan Daci. A synon kjo dispozitë penale të kriminalizojë çdo deklaram “të qëllimshëm” e “të rremë” në çdo lloj shkrese zyrtare apo private? Konkretisht ky nen përcakton shprehimisht se:

“Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet.”

9. Në vijim, meqenëse terminologjia e përdorur në ligj është “dokument” dhe ligji penal nuk ka dhënë një përkufizim të këtij koncepti, me rëndësi është të përcaktohet fillimisht se çfarë quhet dokument në fjalorin e gjuhës shqipe? Sipas Fjalorit të sotëm të Gjuhës Shqipe (<http://www.fjalori.shkenca.org/>) kuptimi gjuhësor i fjalës dokument është:

“1. Shkresë zyrtare që shërben për të dëshmuar ose për të vërtetuar diçka; akt i shkruar që përmban të gjitha ato që janë thënë dhe janë vendosur në një mbledhje, në një gjyq etj.; shënim i mbajtur sipas rregullave të caktuara shtetërore ose organizative. Dokument zyrtar (shtetëror). Dokument i rëndësishëm (sekret). Dokumente të rreme. Dokumentet mjekësore. Dokumentet e mbledhjes. Paraqit (jep, merr, harton, kontrollon) dokumentet.

2. Diçka e shkruar (akt i shkruar, fjalim, vepër, letër etj.) ose e vizatuar që ka vlerë si dëshmi historike. Dokumente arkivore. Dokumente historike.

3. Librezë a fletë e posaçme që i jepet dikujt nga organet shtetërore a nga një organizatë për të vërtetuar se kush është ai ose se është anëtar. I pajisur me dokument. Ruan si sytë e ballit dokumentin.”

10. Nga sa më sipër, vihet re se cilësia kryesore e dokumentit, është aftësia për të “dëshmuar” për diçka. Po çfarë do të thotë dëshmi, sipas Fjalorit të sotëm të Gjuhës Shqipe? Gjuhësisht (por edhe ligjërisht) dëshmia është:

“1. Pohim me shkrim ose me gojë, që bën dikush për të vërtetuar diçka; drejt. pohimi i dëshmitarit para organeve të drejtësisë, fjalët që thotë dëshmitari në gjyq. Dëshmi e përpiktë. Dëshmi e rreme. Dëshmi me gojë (me shkrim).

2. Provë a fakt që vërteton diçka. Dëshmi e gjallë (e qartë). Dëshmi të panumërta. Dëshmi gjuhësore. Dëshmi e miqësisë. Sjell dëshmi. Përbën një dëshmi.

3. Dokument zyrtar që vërteton diçka; dëftesë, vërtetim. Dëshmi shkollore dëftesë. Dëshmi vobekësie. vjet. vërtetim që u lëshohet nga organet shtetërore përpara Çlirimit atyre që ishin të varfër. Mori dëshminë. I lëshuan dëshmi.”

11. Kuptimi ligjor, gjuhësor dhe logjik i fjalës dokument, lidhet me faktin se kjo lloj shkrese (zyrtare ose private) shërben për të provuar një fakt të caktuar. Në të kundërt (*argumentum ad contrarium*), nëse një shkresë nuk shërben për të provuar një fakt apo rrethanë të caktuar, ajo nuk përbën dokument në kuptim të ligjit dhe autori i kësaj shkrese nuk mban përgjegjësi penale për falsifikim dokumenti, në lidhje me deklaratimet “e rreme” të tij në shkresën përkatëse (pa përjashtuar këtu faktin nëse veprimet përbëjnë vepër tjetër penale, si p.sh: “mashtrim” sipas nenit 143 të Kodit Penal, etj, por që nuk gjejnë zbatim për rastin konkret të rekursuesit Luan Daci).

12. Më tej, nëse lexohen në lidhje me njëra-tjetrën nenet 186-192/b të Kodit Penal, vihet re se këto dispozita synojnë të mbrojnë nga falsifikimi ato dokumente që shërbejnë për të dëshmuar apo vërtetuar diçka me vlerë ligjore (p.sh: kontrata noteriale, të dhëna kompjuterike, dokumente shkollore, shëndetësore, letërnjoftime, pasaporta, viza, vula, stampa, formularë, akte të gjendjes civile, etj). Nga ana tjetër, nëse lexohet dhe interpretohet sistematikisht vetë neni 186 i Kodit Penal, arrihet në përfundimin se veprimet e mosveprimet e rekursuesit Luan Daci nuk përbëjnë vepër penale. Paragrafi i parë i nenit 186 të Kodit Penal kriminalizon 1) “falsifikimin” dhe 2) përdorimin e “dokumenteve të falsifikuara”. Paragrafi i dytë kriminalizon më rëndë veprimet e mësipërme kur janë kryer në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda. Ndërsa paragrafi i tretë, parashikon formën më të rëndë të falsifikimit të dokumentit, kur ky falsifikim bëhet nga “personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin”.

13. Koncepti juridiko-penal i “personit që ka për detyrë të lëshojë dokumentin” është shumë i rëndësishëm për të nxjerrë në pah nëse ka apo jo në rastin konkret përgjegjësi penale të rekursuesit Luan Daci. Ligji duhet lexuar dhe zbatuar siç është e jo siç duhet të jetë. Në lidhje me këtë, paragrafi i tretë i nenit 186 të Kodit Penal ndihmon për të kuptuar natyrën e dokumenteve që nuk

duhet të falsifikohen, sipas paragrafit të parë të këtij neni. Norma në këtë rast flet për dokumente, të cilat dikush ka detyrim t'i lëshojë. Çfarë do të thotë të kesh detyrim për të lëshuar një dokument? Çfarë natyre duhet të ketë dokumenti për të cilin dikush ka detyrimin ta lëshojë? Duke e nisur analizën nga kuptimi fillestar gramatikor i fjalës “dokument”, arrihet në përfundimin logjik se dokumentet për efekt të zbatimit të nenit 186 të Kodit Penal, janë vetëm ato shkresa që shërbejnë për të dokumentuar (*dëshmuar, provuar apo vërtetuar*) një fakt të caktuar (*sipas nenit 7 të K.Pr.C “[f]akt quhet çdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqërore ose fenomen i natyrës, të cilit ligji i ngarkon një pasojë juridike*”) dhe jo për çdo lloj shkrese private. Dokumentet që mbron nga falsifikimi neni 186 i Kodit Penal, janë ato për të cilat një person i caktuar ka detyrimin ligjor t'i lëshojë (*siç parashikohet shprehimisht rrethana rënduese në paragrafin e tretë, e cila lidhet, sqaron dhe plotëson paragrafin e parë*). Nëse bëhet fjalë për dokumente për të cilat ligji nuk parashikon një detyrim (kompetencë) për një person të caktuar që t'i lëshojë dhe që nuk shërbejnë ligjërisht për të provuar një fakt të caktuar, atëherë nuk gjen zbatim neni 186 i Kodit Penal. Pra, në këtë rast paragrafi i tretë i nenit 186 të Kodit Penal sqaron edhe më tej kuptimin e paragrafit të parë të këtij neni, i cili ka një formulim që në pamje të parë duket shumë i gjerë, por që i parë në lidhje me paragrafin e tretë, sqarohet mjaft mirë. Nëse ligjvënësi do të kishte dashur të kriminalizonte më gjerë sjelljet njerëzore, do të kishte parashikuar qartë rregulla të tjera.

14. Pyetja vijuese që shtrohet është, a kishte rekursuesi Luan Daci detyrimin të lëshonte dokumentin kërkesë datë 03.02.2017 drejtuar Avokatit të Popullit, për tu emëruar në vendet vakante në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (*i nënshkruar prej tij*), i cili përbën faktin për të cilin ai është deklaruar fajtor dhe dënuar nga gjykatat e faktit dhe që është deklaruar dokument i falsifikuar prej këtyre gjykatave? Nëse do të vlerësohet se ai kishte një detyrim ligjor për lëshimin e këtij dokumenti, atëherë logjikisht ai nuk ka përgjegjësi penale sipas nenit 186(1) të Kodit Penal, por eventualisht një përgjegjësi më të rëndë sipas nenit 186(3) të këtij Kodi. Mirëpo, fakti është se kërkesa për punësim (*aplikimi për shprehje interesi*) në organet e vetingut e rekursuesit Luan Daci si shkresë private e tij drejtuar një autoriteti publik, nuk ishte dhe nuk është dokument në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal, pasi ai jo vetëm nuk kishte detyrim ta lëshonte atë (*kërkesa është akt vullneti të pa-detyruar*), por ligji nuk e përcaktonte si një dokument në të cilin rekursuesi duhej të mos deklaronte “të pavërteta” (*siç janë në të kundërt p.sh: deklaratat që i bashkëlidhen ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*). Dokument në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal është vetëm ai dokument që shërben sipas një parashikimi të posaçëm ligjor për të provuar një fakt të caktuar dhe për të cilin ligji përcakton qartësisht se duhet të përmbajë vetëm të vërtetën. Në këtë pikë janë të gabuara përfundimet e nxjerra nga gjykatat e faktit dhe shumica e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë.

15. Edhe nëse pranohet se kërkesa për punësim e rekursuesit përmban fakte të pavërteta (*deklarimi i tij se nuk ka qenë larguar nga puna për shkaqe disiplinore*), prapë se prapë kjo përbën atë që në doktrinë quhet “falsitet i padobishëm”. Në Shqipëri nuk kam dijeni të ketë pasur ndonjë rast tjetër identik me atë të rekursuesit Luan Daci, ndaj edhe për këtë fakt, Gjykata e Lartë duhej ta vlerësonte rastin e të shprehej në themel për të, duke e zhvilluar praktikën gjyqësore në drejtimin e duhur Kushtetues e Konventor. Nëse i referohemi praktikës së zhvilluar gjerësisht nga kolegët tanë të Gjykatës Supreme të Kasacionit në Itali, ndonëse në një kontekst ligjor të ndryshëm, vëmë re se ata e kanë trajtuar me kujdes të veçantë temën e falsitetit të dokumenteve nga privatët. Gjykata

Supreme e Kasacionit të Italisë, e klasifikon rastin e falsitetit të padobishëm (falso inutile) si atë falsitet që prek tërësisht apo pjesërisht një akt shkresor i cili në vetvete nuk ka aspak vlerë provuese (*shih ndër të tjera vendimin e Seksionit V Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit-Vendimi i 29 majit 2019, nr. 23891.*) Më tej, sipas vendimit nr.23587/2013 Gjykata Supreme e Kasacionit të Italisë ka mbajtur qëndrimin se falsiteti ideologjik i kryer nga privatët në akte publike ndodh vetëm nëse akti publik në të cilin përfshihet deklarimi i privatit, ka si destinacion provueshmërinë e vërtetësisë së fakteve të deklaruara, d.m.th., kur nga një normë juridike lind detyrimi i privatit që të deklarojë vetëm të vërtetën, e që e lidh atë me efekte të caktuara të aktit dokumentar në të cilin zyrtari publik ka përfshirë deklarin. Këto trajtesa na ndihmojnë të kuptojmë më mirë se cili është “falsiteti” ose “gënjeshtër” që dënohet penalisht.

16. Në këtë këndvështrim, Gjykata e Lartë duhej të vlerësonte se përbën falsitet të padobishëm dhe për rrjedhojë nuk përbën veprën penale të falsifikimit sipas nenit 186 të Kodit Penal, çdo deklarim i pavërtetë i shënuar në një kërkesë që i drejtohet një autoriteti publik, kur kjo kërkesë në vetvete është e paaftë për të krijuar automatikisht një marrëdhënie juridike (punësimi në këtë rast), pa kaluar më parë në një fazë verifikimi dhe provueshmërie të fakteve të rëndësishme për lindjen e marrëdhënies së caktuar juridike (*siç parashikohet shprehimisht në Kodin e Procedurave Administrative*). Thënë ndryshe, nuk ka falsifikim dokumenti sipas nenit 186 të Kodit Penal, në rastet kur një individ i dërgon një autoriteti publik një kërkesë, për të cilën ka barrën e provës të provojë me dokumente të tjera (*vërtetime të ndryshme, ose vetëdeklarime nën përgjegjësi ligjore*) vërtetësinë e të dhënave të cilat deklarohen në atë kërkesë. Dokumenti do ketë vlerë për efekt të falsifikimit sipas nenit 186 të Kodit Penal, nëse ka në vetvete vlerë provuese juridike për një fakt të caktuar të rremë që përmban ose është kriter determinant për lindjen e një marrëdhënie juridike e cila nuk do të lindte pa gënjeshtërën e përdorur në dokumentin e falsifikuar. Kjo pasi, jo çdo shkresë përbën dokument në kuptimin penal. Ligji e përcakton vetë llojin e dokumentit ku kërkon shprehimisht deklarime të vërteta nga autori i tij (p.sh: formularët), duke i ngarkuar përgjegjësi penale në të kundërt.

17. Rekursuesi Luan Daci ka pretenduar në rekurs se nuk kishte dijeni për skualifikimin që i kishte bërë ish KLD, me arsyetimin se ai kishte qenë i shkarkuar më parë disiplinarisht si gjyqtar në vitin 1997 për shkelje të rënda të ligjit, në aplikimin e tij të disa muajve para se të dorëzonte kërkesën e datës 03.02.2017 pranë Avokatit të Popullit. Po ashtu, ai ka deklaruar se ka vlerësuar se nuk kishte papajtueshmëri për aplikim për punësim pranë organeve të vetingut. Kjo pasi nga leximi që ai i ka bërë nenit 6(1)(dh) të ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon se “*dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;*”, në referim të afateve të përgjithshme të parashkrimit, ka vlerësuar se masa disiplinore e largimit nga puna ishte parashkruar për shkak të kalimit të një kohe rreth njëzet vjeçare e nuk mund të quhej se ishte në fuqi në kohën e aplikimit. Pra, rekursuesi shprehjen “*ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna*”, e shihte të lidhur me shprehjen “*e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit*” dhe jo siç e interpreton SPAK dhe Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit, se ajo qëndronte më vete dhe përbënte ndalim për rekursuesin që të zgjidhej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

18. Në referim të sa më sipër, gjyqtari në pakicë mendon se nga pikëpamja e ligjit (dhe jo e faktit që del jashtë kompetencave rishikuese të Gjykatës së Lartë) nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm *mens rea* (dashja) e rekursuesit (të dënuarit) Luan Daci, pasi ai ka argumentuar qartë se e ka lexuar dhe kuptuar ligjin sipas mënyrës së tij dhe ka hedhur në kërkesën për punësim, pikërisht këndvështrimin e tij për mënyrën sesi duhet kuptuar ligji. Aq më tepër që në vitin 1997 kur ai është larguar me masë disiplinore nuk kishte një parashikim të ngjashëm ligjor që të ndalonte kandidimin për t'u emëruar gjyqtar të personave që ishin larguar nga një vend i mëparshëm pune me masë disiplinore. Pra, minimalisht rekursuesi ka argumentuar bindshëm se deklaratimet në kërkesën drejtuar Avokatit të Popullit, janë perceptime të tij subjektive në lidhje me kriterin ligjor në fjalë.

19. Nga ana tjetër, edhe sikur rekursuesi ta lexonte dhe kuptonte ligjin ashtu siç kanë arsytuar gjykatat penale që e kanë dënuar dhe për rrjedhojë me qëllim të "gënjente" në lidhje me rrethanën skualifikuese (*qenien i shkarkuar më parë nga detyra e gjyqtarit*), prapë se prapë ai nuk kryente veprën penale të falsifikimit të dokumenteve sipas nenit 186 të Kodit Penal, pasi kërkesa dhe deklaratimet e tij ishin ligjërisht krejt të parëndësishme dhe të pavlera për efekt të punësimit si anëtar i KPA pranë Gjykatës Kushtetuese. Deklarimet e njëanshme të rekursuesit Luan Daci duhej ligjërisht të provoheshin prej tij. Kërkesa për punësim nuk është dokument në kuptimin penal për sa i është ngarkuar përgjegjësia penale rekursuesit. Ajo nuk ka fuqi provuese për asgjë (shih nenin 262 i K.Pr.C), përveç faktit të shfaqjes së vullnetit për të aplikuar për një nga vendet e punës në organet e vetingut (*ai nuk është gjetur fajtor për këtë*). Kërkuesi duhej të kishte paraqitur dokumente nga punëdhënësit e tij (siç kërkohet shprehimisht nga neni 7 i ligjit 84/2016) se nuk është larguar me masë disiplinore, ose kopje të njësuar të librezës së punës ku të dilte shkaku i largimit nga punët e mëparshme.

20. Organet publike (Avokati i Popullit dhe Kuvendi) që kanë administruar procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar të KPA, kishin detyrimin ligjor të kërkonin nga secili prej kandidatëve "prova" të paanshme në lidhje me secilin prej kriterëve të rëndësishme që parashikonte ligji nr.84/2016 "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", veçanërisht për kriteret kualifikuese. Nëse autoritetet kompetente do të dëshironin që të bazoheshin në deklaratimet e njëanshme të aplikantit, kishte vetëm dy mundësi sesi deklaratimet e tij mund të merreshin si provë (*nën përgjegjësinë ligjore për falsifikim apo dëshmi të rreme të aplikantit*): (1) t'i kërkonin atij plotësimin e një formulari të autorizuar nga ligji në të cilin të kërkonin prej tij deklarime nën përgjegjësi ligjore për faktet me rëndësi për aplikimin e tij për punësim, ose (2) ta dëgjonin atë si dëshmitar nën betim dhe ta pyesnin për faktet me rëndësi për kualifikimin apo skualifikimin e tij. Vetëm në këto dy skenarë rekursuesi Luan Daci do të mbante përgjegjësi ligjore për falsifikim ose dëshmi të rreme dhe do të mund të deklarohet fajtor. Por nga faktet e parashtruara prej gjykatave të faktit, qartazi nuk ndodhemi në asnjë prej këtyre rasteve. Ndaj rekursuesi është dënuar për sjellje të tij që në kohën kur janë kryer nuk cilësoheshin si veprë penale nga ligji penal.

21. Kërkesa e datës 03.02.2017 e rekursuesit Luan Daci drejtuar Avokatit të Popullit nuk ka asnjë vlerë provuese në vështrim të neneve 259 e 262 të Kodit të Procedurës Civile si dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative (*referuar faktit se është përdorur në një procedurë administrative*), sa i përket përmbushjes nga ana e tij të kriterëve kualifikuese për t'u zgjedhur anëtar i KPA. Ajo kërkesë provon vetëm që deklaratimet në të janë të atij që i ka

nënshkruar, në rastin konkret rekursuesi Luan Daci, por jo edhe se ato janë të vërteta. Nëse nuk do të ishte kështu, atëherë nuk do të kishte nevojë për hetim administrativ të kërkesave që i drejtohen autoriteteve publike, por ato do të pranoheshin automatikisht mjafton të pohoheshin kushtet ligjore nga kërkuesit. E njëjta logjikë do të duhej të vepronte edhe në proceset gjyqësore, ku p.sh: në gjykimin penal do të duhej të pranoheshin akuzat, vetëm për faktin se prokuroria pohon në kërkesën për gjykim se është kryer një krim dhe se këtë krim e ka kryer i akuzuari, apo në gjykimin civil të pranoheshin automatikisht paditë, mjafton që paditësi të deklaronte se ka të drejtë. Mirëpo, çdo jurist e di se, si në procedurat administrative ashtu edhe ato gjyqësore, kërkuesi ka barrën e provës për faktet që pretendon. Provat janë ato dhe vetëm ato që parashikojnë ligjet procedurale. Një fakt i pretenduar, por i pa provuar sipas ligjit, nuk merret parasysh as në procesin administrativ e as në atë gjyqësor.

22. Në këtë kontekst, i takonte Avokatit të Popullit që në zbatim të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të verifikonte një për një kushtet kualifikuese dhe skualifikuese të kandidatëve për organet e vetingut dhe të kërkonte prej tyre provat përkatëse për vërtetimin e fakteve me rëndësi. P.sh: rekursuesit Luan Daci mund dhe duhej t’i kërkohej vërtetimi nga KLD se në lidhje me shkakun e largimit nga puna si gjyqtar, pasi ai kishte depozituar një vërtetim sipas të cilit ai kishte punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nëse do të vlerësohej nga Avokati i Popullit apo më pas edhe nga Kuvendi, se qenia më parë i shkarkuar disiplinarisht nga puna i një kandidati do të përbënte shkak skualifikues për të, atëherë lindte detyrimi për këto autoritete publike që të kërkonin nga aplikuesit kopje të librezave të tyre të punës, ose çdo vërtetim tjetër, që të provonte mosekzistenca e këtij shkak negativ për kandidatin. Vetëm pyetja në seancën dëgjimore në Kuvend, pa qenë nën betim kandidati (*si dëshmitar*), jo vetëm nuk është e mjaftueshme, por është e pambështetur në ligj. Shumica gabimisht i referohet vetëm kushteve kualifikuese të kandidatëve të përcaktuar në nenin 6 të ligjit nr.84/2016, por anashkalon nenin 7 të po këtij ligji që titullohet “Paraqitja dhe shqyrtimi i aplikimeve për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit”. Në nenin 7 të ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është rregulluar shprehimisht procedura e “verifikimit” të aplikimeve për anëtarë të institucioneve të reja të vetingut. Konkretisht në këtë dispozitë specifikohet se:

“1. Presidenti i Republikës shpall menjëherë thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit në faqen zyrtare të internetit, si dhe në dy gazeta me tirazhin më të lartë në vend. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare ku duhet të dorëzohet dhe listën e dokumenteve që duhet të shoqërojnë atë.

2. Afati për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues është 15 ditë.

3. Kërkesa e kandidatit regjistrohet në regjistrin e protokollit të Presidentit të Republikës. Kandidati pajiset me një dokument që vërteton numrin e aplikimit, datën dhe listën e dokumenteve të paraqitura.

4. Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Në rast se kandidati nuk ka përcaktuar asnjë preferencë për vendin vakant, konsiderohet që ai aplikon për të gjithë vendet vakante. Bashkë-lidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 2 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

a) jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

b) kopje të noterizuara ose të njësuar të diplomës nga organi përkatës;

c) kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuar nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;

ç) një dokument të nënshkruar prej tij, me të cilin aplikuesi pranon kufizimet e posaçme për fshehtësinë në komunikimet elektronike gjatë kohëzgjatjes së mandatit si anëtar i institucioneve të rivlerësimit, sipas shtojcës 1 të këtij ligji.

5. Brenda 7 ditëve nga përfundimi i procesit të aplikimit, Presidenti i Republikës, pasi konsultohet me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, përpilon një listë me kandidatët të cilët plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion dhe një listë me kandidatët të cilët nuk i plotësojnë këto kriteret. Operacioni ndërkombëtar i monitorimit monitoron këtë proces, duke pasur akses të plotë në dokumentacionin e të gjithë aplikantëve.

6. Presidenti i Republikës menjëherë ia përcjell Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit listat e përpiluara, sipas pikës 5, të këtij neni, dhe të gjitha dosjet individuale të kandidatëve, si dhe publikon listën e plotë të kandidatëve në faqen zyrtare të internetit, të grupuar sipas secilit pozicion. Në rast se Presidenti i Republikës nuk përfundon procesin brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e Aneksit të Kushtetutës, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

7. Një komision i përbërë nga të paktën tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit vlerëson kandidatët. Jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja e dy listave nga Presidenti i Republikës, ky komision, bazuar në vlerësimet e arsyetuara, lidhur me kualifikimin dhe për zgjedhjen e kandidatëve, i dërgon rekomandimet Presidentit, i cili ia përcjell ato Kuvendit. Nëse Presidenti nuk e ushtron këtë kompetencë brenda 5 ditëve, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.”

23. Neni 7(4)(c) i ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar qartësisht se kërkesa e aplikantit për shfaqje interesi për emërim në organet e vetingut, nuk është dokument në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal për sa i përket plotësimin ose jo të kriterëve kualifikuese të kandidimit, pasi nëse nuk shoqërohet me dokumentet provuese që vërtetojnë secilin nga kushtet e parashikuara në nenin 6 të ligjit (të cilat duhet të verifikoheshin nga Avokati i Popullit), është e paaftë të sjellë kualifikimin si aplikant që plotëson kriteret formale për kandidim. Për këtë arsye ligji ka parashikuar një fazë verifikimi të kriterëve të kandidimit për secilin prej aplikantëve.

24. Duhet theksuar gjithashtu se në referim të nenit 118(2) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e cila përcakton qartësisht se “[l]igji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte”, si dhe nenit 69 të ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili nuk i ka dhënë tagër Avokatit të Popullit që t’i njohë cilësi dokumentare kërkesave të dorëzuara për aplikim nga kandidatët, ky i fundit (Avokati i Popullit) nuk mund të merrte të mirëqena deklaratimet e njëanshme të aplikantëve për pozicionet në organet e reja të vetingut, por duhej që për secilin kriter ligjor, të kërkonte provën përkatëse shkresore, siç kërkon shprehimisht neni 7(4)(c) i ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

25. Qëllimi dhe funksioni juridik i kërkesës së datës 03.02.2017 drejtuar Avokatit të Popullit, për tu emëruar në vendet vakante në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i nënshkruar nga rekursuesi Luan Daci, dhe i deklaruar dokument i falsifikuar nga gjykatat e faktit, nuk ishte provueshmëria e kushteve për emërim, por provueshmëria vetëm se aplikuesi shfaqte interesit për të aplikuar për emërim në organet e vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Deklarimet e tij në këtë kërkesë, mangësitë në CV-në e tij të depozituar bashkëlidhur aplikimit, apo edhe deklarimi gojor para Kuvendit, nuk pasjellin përgjegjësi për falsifikim të ndonjë dokumenti, sipas nenit 186 të Kodit Penal. Kërkesa për punësim nuk ka në vetvete fuqinë të lindë marrëdhënien juridike të punësimit, për sa kohë që ligji i ka lënë detyrë organeve publike, të verifikojnë dhe ndajnë aplikimet e bazuara nga ato të pabazuara në ligj. Qëllimi i kërkesës për punësim është që të merret në konsideratë aplikimi nga punëdhënësi (*ky efekt nuk diskutohet në këtë çështje*), i cili më pas të vlerësojë me kujdes përmbushjen nga aplikanti të kriterëve që përcakton ligji. Pra, ndryshe nga sa arsyeton shumica dhe sa kanë arsyetuar gjykatat e faktit, kërkesa në vetvete është e paaftë juridikisht të sjellë pasojën e dëshiruar (punësimin) pa kaluar më parë në verifikimin e paanshëm nga punëdhënësi të kushteve që duhet të plotësojë aplikuesi për punësim. Ndaj, kjo nuk është çështje penale, por eventualisht administrativo-disiplinore në kompetencë përfundimtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese. Nëse Kolegji i Posaçëm i Apelimit që vepron pranë Gjykatës Kushtetuese do të konstatonte se Luan Daci i mungonin kushtet fillestare për emërim (*sepse qenia më parë i shkarkuar nga detyra e gjyqtarit është shkak skualifikues*), atëherë në zbatim të nenit 127(1)(d) të Kushtetutës, do të deklaronte vetë mbarimin e mandatit të tij për shkak se do të vërtetoheshin kushtet e pazgjedhshmërisë së tij në funksion. E rëndësishme është të mbahet parasysh se procesi penal nuk është proces administrativ dhe nuk mundet kurrësi për çfarëdolloj shkak ta zëvendësojë atë.

26. Ritheksoj se duke qenë se kërkesa e Luan Dacit nuk ka në vetvete asnjë fuqi provuese të kushteve për emërim apo efekt automatik krijues të marrëdhënies juridike të punësimit, por shërben vetëm për ti krijuar mundësinë aplikantit që ti hetohet dhe vlerësohet aplikimi, ajo shkresë nuk përbën dokument në kuptimin penal. Gabimi i gjykatave të faktit dhe i shumicës në Gjykatën e Lartë është se vlerësimin e fakteve dhe ligjit ato nuk e bëjnë *ex ante* (referuar rrethanave në kohën kur u paraqit aplikimi) por *ex post* (pasi aplikimi rezultoi i suksesshëm dhe lindi marrëdhënia e punës). Nëse Luan Daci nuk do të ishte punësuar në KPA, ai nuk do të ishte proceduar penalisht, por ky procedim penal i bëhet atij vetëm për faktin se aplikimi i tij arriti të jetë i suksesshëm, si rrjedhojë e mos hetimit siç duhet të gjitha kushtet e kualifikimit të tij nga Avokati i Popullit dhe Kuvendi (gjithnjë nëse do të merret e mirëqenë se largimi i tij nga puna me masë disiplinore në vitin 1997, është kriter skualifikues, gjë për të cilën gjykatat penale nuk kanë fjalën përfundimtare).

27. Për arsyet e mësipërme kam bindjen se vendimmarrja e shumicës është e gabuar dhe unë jam kundër saj. Në zbatim të nenit 35(3) të ligjit nr.98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ky mendim pakice i bashkëlidhet vendimit të shumicës dhe publikohet njësoj si ai.

GJYQTAR

Asim VOKSHI